

FALAS

# METRO

KS

17.11.2011

metro-ks.com

**PRESIDENTJA e Kosovës, Atifete Jahjaga, e cilësoi të rëndësishme reformën e sistemit të drejtësisë, ndërsa theksoi që përmirësimet në këtë fushë të jenë prioritet institucional. "Sundimi i rendit dhe ligjit duhet të jetë prioritet kryesor i të gjitha institucioneve të Kosovës. Krijimi i një...**

FAQE 5



## A mjafton vetëm liberalizimi i vizave?

DREJTORI për Ballkanin Perëndimor në Drejtorinë e Përgjithshme për Zgjerim të BE-së, Pier Mirel, kërkon nga institucionet e Kosovës reforma të thella në gjyqësi, administratë publike dhe ekonomi. Ai ia dorëzoi raportin e progresit për vitin 2011 presidentes së Kosovës, Atifete Jahjaga, dhe kryeministrit Hashim Thaçi. Bazuar kryesisht në krijimin e kornizës ligjore, Mirel vlerësoi se raporti i vitit 2011 tregon se në Kosovë ka zhvillime pozitive, por ligjet e miratuara sipas tij duhet të implementohen. "Një çështje të rëndësishme që dëshiroj ta theksoj është sektori i gjyqësisë. Kemi disa vlerëjtje, por konsiderojmë që adoptimi i ligjeve siç është ai për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe i të tjerëve që ndërlidhen me sistemin e drejtësisë pas themelimit të këshillit Gjyqësor dhe prokurorial dhe ritjen...

**Faqe 6-7**

Blej me Starcard me këste pa kamatë.

teb-kos.com / 038 230 000

TEB starcard

4000 1234 5678 9010

VISA

TEB

FITO BONUS

## Brenda

E ardhmja u takon librave elektronike >FAQE 3  
 Kosovë >FAQE 4 - 7  
 60 sekonda >FAQE 10  
 MetroLive >FAQE 12-13  
 MetroLife >FAQE 16-17  
 Zara: Çizme për vjeshtë/dimër 2011/2012 >FAQE18  
 Bota >FAQE 20-21  
 Biznes dhe financa >FAQE 22-23  
 Tech Talk >FAQE 19  
 Sport >FAQE 30-32


## Impressium

**Botues:** N.SH. "METRO - KS";  
**Drejtor:** Astrit KRASNIQI;  
**Kryeredaktor:** Xhavit KAJTAZI;  
**Design:** Kreshnik C. PUSHKOLLI.  
**Lektore:** Emine KOSUMI  
**E-mail:** info@metro-ks.com; marketing@metro-ks.com;  
**Xhirollogaria:** 1501060001013579 Raiffeisen Bank;  
**Shtyp:** ROTOPRINT, Prishtinë. **Tirazhi:** 10.000 kopje.  
**Gazeta shpërndahet FALAS.**


## METRO

### MOTI

10.10.2011



Kosova ende nuk ka hyrë në periudhën e organizimit të riciklimit të letrës. Sa më shpejtë që kjo të ndodhë, edhe përfitimet e ekonomisë sonë do të jenë më të mëdha. Lutemi që pas leximit të gazetës Metro - KS ta ruani dhe ta përdorni për riciklim.



## fotolajm



**Edhe pse temperaturat janë ulur dukshëm furnizimi me rrymë sipas zyrtareve të Korporatës energjetike të Kosovës është stabil. Ata thonë se janë duke i bërë përgatitjet e fundit për dimër, dhe presin se ky vit të jetë më i mirë me furnizimin me energji elektrike për konsumatorët.**



## Gaboni njeh Kosovën

REPUBLIKA e Gabonit edhe zyrtarisht e njohu Republikën e Kosovës. Me këtë njohje, numri i njohjeve ka arritur në 85. Ditë më parë siç dihet njohjen e Republikës së Kosovës e bëri edhe Kuvajti, njohje kjo e cila iu dha ministrit të punëve të jashtme Enver Hoxhaj, i cili qëndroi për vizitë në tri shtetet Emiratet e Bashkuara Arabe, dhe Katar. Pra pritet që Kosovën shumë shpejt ta njohin edhe Katari por edhe Egjipti.

## Lajmi i fundit

KOSOVA ka blerë objektin e parë për një Ambasadë në kryeqendrën evropiane, në Bruksel. Ambasadori i Kosovës në Bruksel, Ilir Dugolli, ka thënë se objekti i Ambasadës ndodhet në qendër të Brukselit dhe i plotëson të gjitha kushtet e nevojshme për punë.

## Jep dorëheqjen Liam Fox

SEKRETARI britanik i Mbrojtjes, Liam Fox dha dorëheqjen pas dyshimeve në rritje lidhur me një mik të tij, i cili u shtir si një këshilltar qeveritar, gjatë udhëtimeve zyrtare jashtë vendit me të. Zoti Fox i kërkoi falje Kryeministrit David Cameron në letër e sotme të dorëheqjes, duke thënë se kishte lejuar gabimisht që interesat e tij personale dhe aktivitetet qeveritare të ngatërroheshin me njëra-tjetrën. Shefi i Mbrojtjes dha dorëheqjen disa ditë para se të fillonte hetimi qeveritar mbi miqësinë e tij me zotin Adam Werritty, një ish-shok dhome i zotit Fox dhe shoqërues i dhëndrit në dasmën e tij, në vitin 2005. Kryeministri Cameron tha se atij i vinte keq të shihte zotin Fox të largohej nga detyra, duke e lavdëruar atë për përpjekjet e tij në drejtimin e fushatave ushtarake britanike në Afganistan dhe Libi. Udhëheqësi britanik ka emëruar Sekretarin e Transportit Philip Hammond si shefin e ri të Mbrojtjes.

Gazeta METRO - KS ruan konfidencialitetin me kompaninë tuaj dhe çdo kontakt i ndërsjellë nuk do të bëhet publik pa lejen tuaj. Po qese pranoni bashkëpunimin mund të na kontaktoni përmes numrit të telefonit dhe e-mail adresës info@metro-ks.com

**MË SHUMË VLERË PARAVE TUAJA**  
 MERR MË SHUMË ME TARIFA TË LEVERDISHME  
 ZGJEDHJA ËSHTË NË DUART TUAJA



E DISPONUESHME NË



Dhe kudo shikoni logon MoneyGram

**MoneyGram**  
 Transferim Parash



www.moneygram.com

© 2011 MoneyGram. të gjitha të drejtat të rezervuara.

## Dëmet nga pirateria e librave në internet



Kindle Fire -minikompjuter i specializuar për leximin e librave elektronikë

## E ardhmja u takon librave elektronikë

AKTUALISHT qëndron i hapur në Frankfurt Panairi i 63 Ndërkombëtar i librit. Këtë radhë pjesëmarrja është më e vogël dhe standat më të bollshme. Shkak është se gjithnjë e më shumë botues orientohen nga tregu elektronik.

Kiendle quhet biblioteka e Andrejt. Ajo është vetëm sa pëllëmba e dorës: e vogël, por me kapacitet të madh. Deri në 1000 tituj librash mund të stivohen në raftet digjitale të minikompjuterit të specializuar për leximin e librave elektronikë. Andrej ka disa dhjetëra, shumica janë libra beletristike, por vetëm shumë pak prej tyre i ka blerë: Të tjerat i ka shkarkuar në internet nga një platformë piratësh. “Unë jam student, por kur të filloj punën do t’i blej librat”, justifikohet 25 vjeçari nga Sllovenia.

Pirateria në internet është një nga problemet më të mëdha të tregtarëve

dhe botuesve. Rreth 60 për qind e librave elektronikë aktualisht shkarkohen në mënyrë ilegale, thotë kryetari i Shoqatës së Librarëve Gjermanë, Gottfried Honnefelder. E megjithatë ekspertët nuk kanë asnjë pikë dyshimi që “e ardhmja është në multimedia”. Juergen Boos, drejtori i Panairit të Frankfurtit, nuk është i vetmi që e thotë këtë. Edhe shifrat flasin një gjuhë shumë të qartë: Vetëm këtë vit xhiroja me të ashtuquajturat e-books pritet të trefishohet, siç parashikohet në një studim të kompanisë këshilluese Pricewaterhouse Coopers. Deri në vitin 2015 xhiroja me librat elektronikë pritet të arrijë në 255 milionë euro në vit, kjo do të thotë një rritje me nga 52 përqind në vit, ndërsa për tregun e librit të shtypur parashikohet një rritje prej 1,2 përqind 10,25 miliardë euro. Në Gjermani segmenti i librave elektronikë është ende i vogël, por

zhvillimi i aparateve të reja elektronike (e-reader) dhe kompjuterave tablet (ipad) kanë bërë që interesimi të rritet me hapa të mëdha, bëhet e ditur në të njëjtin studim. Panairi i Frankfurtit i ka kujtuar kësaj teme një sërë konferencash dhe takimesh. Edhe Frankfurt Academy ka reaguar duke ftuar në seminarët e saj me editorët e rinj personalitete si David Naggat nga Amazon apo Mitch Joel nga Twist Image. Në hapësirën shqipfolëse ky segment ende nuk ka filluar të zërë vend. “Në Kosovë kërkesa për librin elektronik është ende e vogël”, thotë Besian Zeneli, kryetari i Shoqatës së Botuesve. Në Shqipëri interesimi duket të jetë më i madh, sipas tregtuesve, por mungon interesimi i botuesve për investim. “Por edhe Shqipëria së shpejti do t’i bashkohet këtij trendi”, është i bindur botuesi i Onufrit, Bujar Hudhri. (DV)

**METRO**  
KS

11 mundësi - 11 dimensione

Përcaktohuni për formatin që dëshironi ta publikoni biznesin tuaj

Mob:  
049  
128  
542

**GAZETË FALAS**  
10.000 KOPJE  
PËR TË GJITHË

swatch<sup>®</sup> 



swatch



swatch



swatch



swatch



Pamje nga akademia përkujtimore në Pejë

## Akademi Përkujtimore në Pejë

# Adrian Krasniqit, urdhri "Hero i Kosovës"

PRESIDENTJA e Republikës së Kosovës, zonja Atifete Jahjaga mori pjesë dje në Pejë në manifestimin kushtuar 14-vjetorit të rënies së heroit të kombit, Adrian Krasniqi. Fillimisht ajo vuri lule te lapidari i Adrian Krasniqit, ndërsa më pas mori pjesë në akademinë përkujtimore. "Unë, presidentja e Kosovës, kam dekoruar me urdhrin "Hero i Kosovës" Adrian Krasniqin për trimërinë dhe përkushtimin e treguar gjatë Luftës Çlirimtare të

Kosovës dhe për flijimin e tij për pavarësinë e Kosovës", tha presidentja e Kosovës, e cila e dekoroi me çmimin më të lartë institucional njërin nga çlirimtarët e orëve të para të UÇK-së. Në akademinë përkujtimore folën edhe kreu i Pejës Ali Berisha, bashkëlufëtari i Ardian Krasniqit, Rexhep Selimi, ndërsa në emër të familjes pjesëmarrësit i përshëndeti Ilir Krasniqi, Adrian Krasniqi (komandant "Rexha"), u vra gjatë sulmit policor serb në fshatin Kliqinë të Pejës, në mëngjesin e 16 tetorit 1997.

## Rriten t të hyrat e shtetit

MINISTRI i Financave Bedri Hamza gjatë prezantimit të raportit nëntëmujor të buxhetit ka deklaruar se këtë vit ka ngritje substanciale të të hyrave krahasuar me vitin e kaluar. "Të krrat gjatë nëntëmujorit të vitit 2011, duke mos përfshirë grandet e përcaktuara të donatorëve si dhe fondet në mirëbesim, janë 933.1 milionë euro. dhe paraqesin 74 për qind të pranimeve të përgjithshme vjetore të planifikuara, ndërsa kemi një rritje prej 4 për qind, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak", tha Ministri Hamza.



Bedri Hamza, ministër i Financave i Republikës së Kosovës

## KFOR-i shtyn afatin për barrikatadat Rrugët hapen të martën



Erhard Drews, komandanti i KFOR-it

KFOR-i ka bërë të ditur se ka shtyrë për të martën afatin e largimit të e barrikadave, duke iu ofruar mundësi të tjera serbëve. “Komandanti i KFOR-it, Gjenerali Erhard Drews ka shtyrë kohën e konvojeve të KFOR-it për furnizimin e trupave të KFOR-it në pikat kufitare deri të martën, duke u dhënë më shumë kohë qytetarëve të veriut të Kosovës në largimin e barrikadave rrugore”, thuhet në një komunikatë për media të KFOR-it. Përfaqësuesit e komunave të Leposaviqit, Mitrovicës veriore, Zubin Potokut

dhe Zveçanit kanë kërkuar më shumë kohë dhe komandanti i KFOR-it ka vendosur t’u ofrojë një ditë shtesë. Komandanti i KFOR-it ka vlerësuar vullnetin e tyre për t’i hapur rrugët për furnizimin e trupave të KFOR-it në Portën 1 (Jarinë), Pikën 31 (Bërmjakë) dhe Kampin Nothing Hill. Të premten, KFOR-i dha ultimatum për largimin e barrikadave deri të dielën pasi të hënën do t’i hiqte vet, por kjo nuk ka ndodhur. Afati shtyhet për të martën.

## Sundimi i ligjit, prioritet institucional

PRESIDENTJA e Kosovës, Atifete Jahjaga, e cilësoi të rëndësishme reformën e sistemit të drejtësisë, ndërsa theksoi që përmirësimet në këtë fushë të jenë prioritet institucional.

“Sundimi i rendit dhe ligjit duhet të jetë prioritet kryesor i të gjitha institucioneve të Kosovës. Krijimi i një sistemi efikas dhe transparent të drejtësisë në shërbim të qytetarëve është elementi më i rëndësishëm i realizimit të këtij qëllimi”, u shpreh Jahjaga. Këto komente presidentja i bëri në Kuvendin Zgjedhor të Odës së Avoketëve të Kosovës.



Atifete Jahjaga, presidente e Kosovës



## Presidentja Jahjaga në "Takimet e Gjeçovit"

PRESIDENTJA e Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga, mori pjesë në manifestimin jubilar, të 40-tin, "Takimet e Gjeçovit" në Zym të Hasit, nga i cili manifestim ajo u nderua me Çmimin "Unaza e Katarina Josipit".

## Shqiptarët JO Serbisë dhe Maqedonisë

SHQIPTARËT janë faktorë në Ballkan. Përbëjnë dy shtetet, Shqipërinë dhe Kosovën, edhe shqiptarët në Maqedoni dhe Serbi kanë treguar së fundi se mund tu japin drejtim zhvillimeve. Bojkotimi i regjistrimit të popullsisë nga shqiptarët në Maqedoni bëri që të dështoj gjithë procesi. Maqedonasit sipas shumë mediave shqiptare, i frikësuan regjistrimit për shkak të numrit në rritje të shqiptarëve prandaj vepruan asisoj që të dështoj procesi. Edhe pse zyrtarisht në Serbi, regjistrimi ka përfunduar të shtunën, në këtë vend është shtyrë afati edhe për tri ditë për shkak të refuzimit të shqiptarëve të Luginës së Preshevës për tu regjistruar. Mësohet se në Serbi janë regjistruar rreth 7.1 milionë banorë ndërsa në Luginën e Preshevës vetëm 3% e popullsisë që është minoritare.

## Britani, jo më patenta në shqip

DHËNIA e provimit të teorisë së makinës në gjuhë të huaj për shoferët në Britaninë e Madhe u lejua nga ish-qeveria laboriste. Aktualisht rregullat lejojnë dhënien e provimit të teorisë në 19 gjuhë të huaja, përfshi këtu edhe gjuhën shqipe.

Në total, mbi 93 mijë provime të teorisë janë dhënë në gjuhë të huaja si 12 mijë në polonisht apo 300 në gjuhën shqipe, madje lejohet të marrësh pjesë në provat e praktikës dhe duke pasur me vete një përkthyes.

Por, qeveria aktuale britanike do të ndalojë marrjen e testeve të patentave të makinës në gjuhë të huaja. Shkaku është frika në rritje se dhjetëra persona që kanë marrë patentat nuk dinë të lexojnë shenjat e rrugëve të shkruara në anglisht. Ministri i Transporteve, Mike Penning, tha se siguria në rrugë dhe jo korrektesa politike duhet të jetë prioriteti ynë. Sipas shifrave zyrtare, më shumë se 1500 vetë kanë dhënë provimet e teorisë për shoferë autobusash në gjuhë të huaja. Taksapaguesit britanikë paguajnë për kostot e përkthimeve të testeve të teorisë në gjuhë të huaja, ndërkohë që për përkthimet në provimin e praktikës e paguajnë vetë praktikantët. Zyrtarët e transportit besojnë se në vendet e tjera rrallë lejohet që provimet e teorisë dhe praktikës të bëhen në gjuhë të huaja.

## A mjafton vet

DREJTORI për Ballkanin Perëndimor në Drejtorinë e Përgjithshme për Zgjerim të BE-së, Pier Mirel, kërkon nga institucionet e Kosovës reforma të thella në gjyqësi, administratë publike dhe ekonomi. Ai ia dorëzoi raportin e progresit për vitin 2011 presidentes së Kosovës, Atifete Jahjaga, dhe kryeministrit Hashim Thaçi. Bazuar kryesisht në krijimin e kornizës ligjore, Mirel vlerësoi se raporti i vitit 2011 tregon se në Kosovë ka zhvillime pozitive, por ligjet e miratuara sipas tij duhet të implementohen.

"Një çështje të rëndësishme që dëshiroj ta theksoj është sektori i gjyqësisë. Kemi disa vërejtje, por konsiderojmë që adoptimi i ligjeve siç është ai për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe i të tjerëve që ndërlihen me sistemin e drejtësisë pas themelimit të Këshillit Gjyqësor dhe prokurorial dhe rritjen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve mendoj se qytetarët e Kosovës do të presin një punë më të mirë nga drejtësia", u shpreh Mirel. Presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga paralajmëroi se në kuadër të kompetencave kushtetuese do të udhëheqë mekanizmat për luftimin e korrupsionit. Ajo theksoi se Kosova e ka për obligim t'i largojë të gjitha pengesat e evidentuara në raport. Zonja Jahjaga u ndal te zhvillimet politike në Kosovë dhe rajon. Ajo shprehu edhe njëherë qëndrimin e saj kundër çdo zgjidhje për Kosovën dhe veriun e saj jashtë planit të Ahtisarit. "Unë si presidente e Kosovës jam kundër "Ahtisarit plus", kundër administrim-



**FALAS**  
**METRO**  
KS

**11 MUNDËSI  
DIMENSIONE**

**Përcaktohu për  
formatin që  
dëshironi ta publikoni  
biznesin tuaj**

**Kontakti  
Mob: +386 (0) 49/ 128 - 542**

Reklama numër 1  
274.6 x 184.77  
Faqe e plotë

Reklama numër 2  
137.3 x 184.77  
1/2 e faqës

Reklama numër 5  
112 x 184.77

Reklama numër 6  
73 x 184.77

Reklama numër 7  
137.3 x 92.385



# tëm liberalizimi i vizave?



**Pier Mirel, drejtor për Ballkanin përëndimor në BE, ia dorëzon raportin e progresit presidentes së Kosovës Atifet Jahjaga**

Foto: Koha.net

it ndërkombëtar në tri komuna të Kosovës sepse kjo nuk është në përputhje me Kushtetutën e vendit, do të nxishte pabarazi dhe shpërngulje të popullsisë nga një komunë në komunën tjetër”, theksoi Jahjaga.

Pas takimit me kryeministrin Hashim Thaci dhe ministren e integritimit, zoti Mirel sqaroi detaje të raportit të progresit të cilat sic tha ai kanë mundur të keqkuptohen.

Në raport është përmendur që veriu të Kosovës i duhet një agjende gjithëpërfshirëse për veriun, ndërsa strukturat paralele të Serbisë, janë quajtur thjeshtë si struktura të ndara.

“Këto ide vijnë nga vizita e komisionerit Stefan Fyle në veri vitin e kaluar. Nuk ka asnjë ide për ndryshimin e agjendës politike”, tha Mirel.

## Shpend Maxhuni, drejtor i Policisë

KRYEMINISTRI i Republikës së Kosovës, Hashim Thaci, ka emëruar të enjten Shpend Maxhunin, drejtor të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës. Emërimi i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë bëhet për një periudhë tri vjeçare.

## Do të shfrytëzojmë rrugët tokësore

KFOR-i synon t'i shfrytëzojë rrugët tokësore prej ditës së hënë për t'i furnizuar trupat e saj ushtarake në Portën 1 dhe 31, si dhe në Kampin “Nothing Hill”. KFOR-i do ta bëjë këtë të hënë në mënyrë paqësore për ta lehtësuar kalimin e konvojit të automjeteve inxhinierike, thuhet në komunikatën e KFOR-it, të cilën e kanë lëshuar mbrëmë von pas takimit me strukturat paralele në Leposaviç. Komandanti i KFOR-it, generali Erhard Drews, pas takimit me përfaqësuesit e veriut të Mitrovicës, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviçit, ka kërkuar që kalimi në rrugët e vendit të mos pengohet nga askush. “Takimi është mbajtur në atmosferë shumë konstruktive. Të dyja palët pranuan të drejtën e lirisë së lëvizjes për popullatën dhe për KFOR-in, EULEX-in dhe të tjerët...

**GAZETË FALAS**  
10.000 KOPJE  
**PËR TË GJITHE**

Reklama numër 3  
274.6 x 85

Reklama numër 4  
200 x 111

Reklama numër 8  
100 x 73

Reklama numër 9  
50 x 73

Reklama numër 10  
50 x 35

Reklama numër 11  
15.05 x 184.6

E-mail: [marketing@metro-ks.com](mailto:marketing@metro-ks.com) Web: [www.metro-ks.com](http://www.metro-ks.com)

1875 1975  
**Heineken**  
APRÈS-SKI





## Kuriozitete

### Vila e Pitt-Jolie në shitje për 14 milionë \$

ÇIFTI i aktorëve më të paguar në botë, Brad Pitt dhe Angelina Jolie, kanë nxjerrë në shitje një prej vilave të tyre, e ndodhur në Malibu, për një vlerë prej 13,75 milionë dollarësh. Ndërsa janë shumë të paktë njerëzit në botë që e kanë mundësinë ta blejnë, të gjithë të tjerët mund të shohin se përse kjo shtëpi, ku ata pothuajse nuk kanë banuar kurrë, vlen kaq shumë. E ndodhur mbi një shkëmb me pamje nga Oqeani Paqësor, shtëpia ka një oborr të madh me pemë dhe bar, pishinë, fushë tenisi dhe vende të tjera për relaks. Dykatëshe, vila ka një hapësirë të pamatë brenda saj, është e pajisur me jakuzi, palestër dhe kinema private e komoditete të tjera përrallore, të gjitha të vendosura në një hapësirë prej pothuajse 2 mijë metrash katrorë. Kjo është një prej vilave të çiftit Pitt-Jolie, të cilët kanë vila të tjera në Los Anxhelos, Nju Orlins, Francë dhe Itali. Nuk dihen arsyet përse çifti hollivudian ka vendosur të shesë këtë pasuri.



Vila ne Malibu e çiftit Brad Pitt dhe Angelina Jolie nxirret në shitje për një vlerë prej 13.75 milionë dollarësh



### Zvicër, bën seks me qenin, burgoset

NJË 25-vjeçar zviceran është dënuar me tetë muaj burg pasi pranoi që kishte kryer marrëdhënie seksuale me qenin e tij. Burri i cili zbuloi edhe detaje të tjera (i jepte çokolatë dhe ndizte qirinj para aktit seksual) tha se ka pasur marrëdhënie të rregullta me qenin e tij Appenzeller që nga viti 2008. 25-vjeçari u paraqit në gjykatën e Liestalit me varësen e qenit të varur në qafë ku ishte shkruar: "Partneri im i jetës." Gjithsesi ai pranoi se nuk i ka qëndruar besnik qenit të tij sepse ka shkuar edhe me dy qen të tjerë. Përveç dënimit me burg, zvicerani është detyruar që të fillojë edhe konsultat me një psikolog.

 **BANKA PËR BIZNES**  
Mundësi për më shumë...

SMS Bilanc



SMS Njoftim



SMS - Njoftim dhe SMS - Bilanc

Ju vetëm duhet të dërgoni një SMS

Për informata më të hollësishme drejtohuni në njerën nga 42 njësitë e Bankës për Biznes në tërë Kosovën.

INFO

[www.bpbbank.com](http://www.bpbbank.com)

**metrokult****Agollit, titulli  
"Drita e Minatorit"**

MITRO-  
VICA  
nderoi  
shkrimtarin shqiptar Dritëro Agolli me



Agolli me certifikatën "Drita e minatorit", gjatë një aktiviteti të zhvilluar me drejtues dhe zyrtarë të institucioneve lokale dhe qendrore, shkrimtarë, poetë, krijues dhe dashamirës të letërsisë në qendrën e kulturës "Rexhep Mitrovica", në Mitrovicë. Veprimtaria, që u mbajt nën përkujdesjen e ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Memli Krasniqi, iu kushtua poetit Dritëro Agolli, në 80-vjetorin e lindjes së tij.

**Ndërroi jetë aktori  
Ali Ahmeti**

**KA ndëruar jetë aktori i njohur kosovar, Ali Ahmeti, pas një sëmundje të rëndë me të cilën u ballafaqua që prej kohësh. Vdekja e Ali Ahmetit, babait të nënkryetarit të "Lëvizjes Vetëvendosje", Shpend Ahmeti, është pritur në "zi" nga mijëra dashamirës të kulturës. Ali Ahmeti njihet për rolin e "Elezit" në serialin vendor "Kafeneja Jonë".**

**Vdiç shkrimtari  
Mehmet Haziri**

NE moshën 64 vjeçare, pas një sëmundjeje të rëndë, ndërroi jetë Mehmet Haziri, gazetar shumëvjeçarë i Radio Prishtinës dhe redaktor i Radio Kosovës. Ai filloi punën në Radio Prishtinë në vitin 1977. Pas mbylljes së Radio Prishtinës në vitin 1990, Mehmet Haziri bashkë me një ekip të gazetarëve të RTP-së, nisën një emision pesëminutësh informativ në Radio Zagreb të Kroacisë. Nga viti 1991, bashkë me disa gazetarë të RTP-së u caktua me punë në Radio Televizionin Shqiptar si koordinator i kësaj redaksie në Prishtinë. Në vitin 1995 Mehmet Haziri është nderuar me çmimin Gazetar i vitit, çmim ky i ndarë nga Lidhja e Gazetarëve të Kosovës. Varrimi i të ndjerit u bë dje në varrezat e fshatit të tij të lindjes, Leçinë të Skenderajt.



**Piro Milkani nuk e kishte menduar asnjëherë se një ditë do të realizonte një dokumentar mbi Kadarenë. Rreth tre vjet më parë, së bashku me djalin e tij, Eno Milkani, nisën të vinin në jetë atë që Dritan Hoxha kishte shkruar në letër. Ishte një amanet, tashmë i përmbushur...**

**Bisedoi: Oliverta Lila**  
60sekonda@metro-ks.com

■ **Gjirokastrë, Moskë, Oviedo, Paris...Si ishte ky bashkudhëtim me Ismail Kadarenë?**

Edhe pse Kadarenë e njihja prej shumë vitesh, kisha bashkëpunuar për filmat "Përse bie kjo daulle" dhe "Ballë për ballë", ky ishte një bashkudhëtim shumë interesant. Nisi nga Gjirokastra. Nuk e kisha vizituar më parë shtëpinë e tij. U befasona vërtet kur pashë atë shtëpi. Përputhej plotësisht me imazhin që më kishte krijuar për të "Kronikë në gur". Me modesti Kadare nuk e ka thënë asnjëherë, por ajo shtëpi ishte një kështjellëz e vogël. Asgjë nuk ishte e përcaktuar përfundimisht në këtë bashkudhëtim. Ndryshe nga sa mund të prisja, Kadare kishte dëshirë që në qytetin e tij të lindjes, një nga njerëzit që donte të takonte ishte Rraq Paskali, poet, skulptor, një njeri paksa i çuditshëm. Në një intervistë të dhënë dikur ai ishte shprehur: "Në këtë Sokakun e të Marrëve, tre personazhe janë të famshëm: Enver Hoxha, Kadareja dhe unë. Njëri vdiq, tjetri ka ikur, kam mbetur vetëm unë. Ismailit i kishte pëlqyer sinqeriteti i asaj deklaratë. Moska pastaj ishte një tjetër surprizë për mua. Nuk e kisha vizituar më parë. Kadare e kishte me mëdyshe udhëtimin drejt Rusisë, por insistova që ai të rikthehej në Moskë. Pa këtë pjesë filmi nuk do të kishte të njëjtën vlerë. Kur zbriti në aeroport, me një shprehje serioze më tha që nuk ishte shumë i emocionuar, por ai i fshihte emocionet. Të nesërmen e asaj dite, pas vizitës në institutin Gorki, në klasën ku kishte studiuar dhe në takimet me studentët pasuniversitarë të këtij instituti, Kadare tregoi se pas viteve '90 kishte pasur dëshirë për t'u rikthyer, por nuk ia kishin lejuar rrethanat. Interesante ishte vizita në shtëpinë-muze të shkrimtarit Boris Pastërnak dhe në varrin e tij ku Kadare kujton edhe sulmin që i bëhej atij në institutin "Gorki". Oviedo e Spanjës ishte po ashtu një udhëtim shumë interesant. Qyteti

jetonte me atmosferën e ndarjes së çmimit "Princi i Asturias" për 7-8 laureatët në të gjitha fushat e shkencës. Në rrugë hasje portretet e tyre e po aty mund të blije edhe çokollata të markës "Kadare".

■ **Parisi dhe pastaj këndi ku shkrimtari "thërret muzat"...**

Parisi e njihja, por surpriza ishte që Kadare na lejoi të bëjmë një bashkëbisedim të gjatë në këndin e kafenesë ku ai shkruan prej gati 20 vitesh. Në një farë mënyre, ajo tavolinë ku ulet çdo mëngjes ka tashmë emrin e tij. Kur shkuam atje, kishim një dyshim të madh nëse pronari do të na lejonte të bënim xhirime. Por sapo i shpjeguam se bëhej fjalë për Kadarenë, u tregua shumë i gatshëm. Ai shkruan në mënyrë sistematike atje. Më kujtohet që në vitin 1978, teksa bashkëpunonin me të dhe Çashkun për filmin "Ballë për ballë" e kam pyetur se sa faqe shkruan në ditë. Ai më tha tri. Kaq pak?, i thashë unë. Kadare më pa me habi dhe më tha: këto shumëzoi me 365 ditë. Kishte të drejtë, bëheshin më shumë se njëmijë faqe.

■ **A e kishit menduar më parë se mund të realizonit një dokumentar mbi jetën e Ismail Kadaresë?**

Jo, nuk e kisha menduar më parë. Përfito nga rasti të them që ishte një ide e admirueshme e Dritan Hoxhës, për të cilin kam pasur shumë admirim. Ai ngriti nga hiçi një perandori mediatike dhe e kishte lënë amanet realizimin e një dokumentari mbi Kadarenë. Kënaqësia ime ishte edhe fakti që shkrimtari pranoi që këtë dokumentar ta xhironin Milkani. Unë shpresoj që ata që do ta shohin filmin, të kuptojnë akoma më shumë vlerën e këtij shkrimtari të madh.

# Rudina Xhunga bëhet nuse

DJE, gazetarja e mirënjohur e emisionit "Shqip" në "Top Channel", Rudina Xhunga, kreu ritin zyrtar të martesës me diplomatin, ish-punonjësin e Ministrisë së Punëve të Jashtme e më pas analist për çështjet ndërkombëtare, Dritan Hilën. Ishte menduar të ishte një ceremoni e thjeshtë celebrimi, nga ato që organizohen paraditeve në Bashki, ku dëshmitarët dhe çifti vetë hedhin firmat, i bëjnë premtime njëri-tjetrit dhe shijojnë në heshtje ditën e tyre të lumturisë. Por çifti është përballur me një surprizë të këndshme nga miqtë e tyre. Ceremonia u zhvillua në Njësinë Bashkiake Nr. 5. /bw/panorma/



## aforizëm

Cilën qeveri mund ta quajmë si qeverinë më të mirë? Për mua, atë që na mëson se si të qeverisim veten.

Johann Wolfgang von Goethe



## metrokult Adelina thyen këmbën në Paris

ADELINA Ismajli u kthye në lajme, pasi që u bë e ditur se po e xhiron një videoklip të ri nëpër rrugët e kryeqytetit francez, Paris, aty ku edhe po jeton. Por, jo gjithçka duket të ketë shkuar mirë. Ajo është kontaktuar nga një media për intervistë, por stafi ka thënë se këngëtarja e ka lënduar këmbën seriozisht ditëve të fundit. Adelina është në përgatitje të albumit të ri.




## Panairi i 14-të i librit Tirana 2011

**NË Pallatin e Kongreseve të enjten përfundoi Panairi i 14-të i librit "Tirana 2011", ku lexuesit patën mundësi të njihen me botimet shqiptare të vitit të fundit. Gjithashtu ai është edhe vendtakimi më i rëndësishëm dhe më i madh i autorëve dhe shtëpive botuese nga të gjitha trevat ku jetojnë shqiptarë, ku flitet e shkruhet shqip. Në panair morën pjesë rreth 80 shtëpi botuese.**

## 100 vjet nga lindja e Migjenit

NË Teatrin Kombëtar u zhvillua aktiviteti kushtuar 100-vjetorit të lindjes së Migjenit. Artistë si dhe figura të



tjera të njohura u mblodhën për të vlerësuar figurën dhe veprën e poetit më në zë të letërsisë shqiptare, që ka lënë gjurmë me krijimtarinë e tij unike, bën të ditur top-chanel. Poezite e njohura të Migjenit u recituan me mjeshhtëri dhe ndienjë nga aktorë të njohur të skenës dhe ekranit si Bujar Asqeriu, Suela Konjari, Vasjan Lame e shumë të tjerë.

## fjalë e urtë

Nënprefekt u bë Sadiku, veç tri ditë qëndroi e iku.

anektotë

## GJYGIMI I ÇAJIT

Shkon njëri n'Shtime, n'pazar. E sheh njërin që kish ra në varfëri e e kishte qitur për ta shitur edhe gjygymin e çajit. E kishte pas shitur edhe tokën, e tash e kishte qitur për ta shitur edhe gjygymin. Po e pyet ky tjetri.

- A po e shet gjygymin a?
- Po, po e shes - përgjigjet ky.
- E muarr në duar e po e shikon gjygymin e po i thotë:
- I mirë tek ashtë, po pak i vogël po doket!
- N' dash i vogël e n'dash i madh, qyky gjygymin mi ka hangër dymdhetë hekter tokë...





## Nëna e Jobs nuk e di se i ka vdekur djali

**DUHET** të jetë e vështirë që të gjesh ende njerëz në botë që të mos jenë venë në dijeni për vdekjen e "babait" të "iPhone" dhe "Apple". Megjithatë, pas të gjithë fushatës që u bë si rrjedhojë e ndarjes nga jeta të një prej njerëzve që i kanë bërë më shumë për teknologjinë informatike dhe pas të gjithë ngushëllimeve që kanë ardhur nga e gjithë bota, nëna biologjike e tij nuk e di ende këtë fakt.

**79-vjeçarja, Joanne Simpson**, është në një gjendje aq të rëndë, sa që e ka të vështirë të kujtojë edhe emrin e saj, ndërsa ka humbur aftësinë për të dalluar dhe komunikuar me të afërmit e saj. Besohet se Jobs ka vendosur kontakt me Joanne përpara se të vdiste, por nuk e bëri këtë asnjëherë me babain e tij, i cili gëzon një gjendje të mirë shëndetësore në të 80-tat e tij dhe i kërkoj publikisht një takim djalit të tij biologjik.

## Shtohen numri i kandidatëve të

# Karriga e ëmb

**NDRYSHIMI** i Kushtetutës sa i përket mënyrës së zgjedhjes së presidentit, që po debatohet edhe me qytetarë në qendra të ndryshme të Republikës së Kosovës, ka shtuar numrin e nominimeve të mundshme për të parin e vendit. Tashmë partitë më të mëdha politike kanë zbardhur emrat e mundshëm të kandidatëve të tyre që do të mund të nominoheshin për këtë post të rëndësishëm, të cilin aktualisht po e mban presidentja Atifete Jahjaga...

Ndër emrat që po lakohen, është ai i ish - nënkryetarit të LDK-së dhe kryetarit të LDD-së, dr. Nexhat Daci, i cili edhe vetë e ka pohuar një gjë të tillë se e dëshiron postin e të parit të Kosovës. Partia tjetër

Nga **Besim KAJTAZI**

opozitare, Alenca për Ardhmërinë e Kosovës edhe pse nuk e ka shpallur botërisht, pritet që për president ta nominojë numrin dy i kësaj partie, Blerim Shala. Nga Lidhja Demokratike Kosovës, ditë më parë është njoftuar se ata e përkrahin për këtë post, presidenten aktuale znj. Atifete Jahjaga, e cila në këtë detyrë erdhi pas marrëveshjes ndërmjet kryeministrit Hashi Thaçi, kryetarit të Prishtinës z. Isa Mustafa dhe ish-kryetarit të Aleancës për Kosovën e Re, e cila siç dihet u bë në prani të njeriut me ndikim, ambasadorit të SHBA-së, Kristofer Dell. Në anën



Atifete Jahjaga



Jakup Krasniqi

## La keqpërdorin emrin...

**JESSICA** Alba është hidhëruar kur e kuptoi se kompania "Belly Bandit" e shfrytëzon emrin e saj për promovimin e produkteve për dobësim, të cilat femrat i përdorin pas lindjes. Alba ngriti padi dhe kërkon një milionë dollarë për shkak të përdorimit të paautorizuar të emrit të saj dhe fotografive në faqen e internetit të kompanisë në fjalë. Sapo që e ngriti padinë, firma "Belly Bandit" e hoqi emrin e saj nga faqja. Aktorja si dëmshpërblim kërkon edhe një pjesë të fitimit që kompania e fitoi duke shfrytëzuar emrin e saj.



## Rikthehen targat KS

- **MINISTRIA e Punëve të Brendshme ka rikthyer në sistemin e regjistrimit të automjeteve edhe targat e vjetra KS. Prej 1 nëntorit, sipas Ilhami Gashit, Sekretar Permanent i kësaj Ministrie, veturat që do të regjistrohen në Kosovë do të mbajnë zyrtarisht dy lloj targash.**
- **Nëse të gjithë serbët i përgjigjen kësaj ftese, që është pjesë e marrëveshjes për lëvizje të lirë, rreth 600 mijë vetura do të bartin regjistrimet e kohës kur Kosova administrohej nga OKB, bën të ditur portali rtklive.com..**
- **Edhe regjistrimet e veturave në Kosovë do të tregojnë ndarjen etnike. Ministria e Punëve të Brendshme, prej javës së ardhshme do të fillojë një kampanjë ku fton të gjithë serbët e Kosovës që t'i përgjigjen regjistrimit të veturave me targat e vjetra të UNMIK-ut.**



Hashim Thaçi dhe Fatmir Sejdiu

mundshëm për të parin e Kosovës

# ël e presidentit...

tjetër, Partia Demokratike e Kosovës, e cila në qeverinë e re mbanë dy poste të rëndësishme, atë të kryeministrit dhe të kryeparlamentarit, ende nuk është deklaruar zyrtarisht për emrin e kandidatit të saj, edhe pse këtë në një mënyrë e ka pranuar kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi, i cili për disa muaj e pati ushtruar këtë detyrë. Mirëpo, postin e presidentit mbase mund ta sfidojë edhe kryeministri aktual i Kosovës dhe kryetari i PDK-së Hashim Thaçi, edhe pse ai nuk e pohoi këtë në mediat kosovare, madje as në emisionin Rubikon të KTV-së, kur drejtuesi i bisedës Adriatik Kelmendi disa herë e “bombardoj” me pyetjen se a do të kandidohet kryeministri për president të Kosovës... Një kandidat tjetër për president të Kosovës, gjithsesi pritet që të jetë edhe zëvendëskryeministri i tashëm Behgjet Pacolli, të cilit një herë koalicioni PDK –

AKR ia besoi këtë post... Nuk përjashtohet mundësia që për postin e presidentit të kandidohet edhe ndonjë kandidat i Lëvizjes Vetëvendosje. Mbase ky mund të jetë kryetari i kësaj partie, Albin Kurti, por edhe ndonjë kandidat i pavarur që do të mund të deponojë 15 mijë nënshkrime të qytetarëve. Këtë mbase mund të pritët ta bëjë ish-presidenti, dr. Fatimir Sejdiu, të cilit postin “ia mori” Gjykata Kushtetuese e Kosovës! Sipas paralajmërimeve, të cilat i bëri publike në debat me qytetarë, kryetari i Komisionit për ndryshime kushtetuese dr. Arsim Bajrami, zgjedhjet e radhës për president të Republikës së Kosovës, pritet të mbahen në fund të shtatorit të vitit të ardhshëm. Pesha e këtij posti do të jetë më e madhe, pasi që presidenti do të zgjedhet me shumicë të votave të qytetarëve, 50+1.




## Pakistani shqyrton njohjen e Kosovës

**KRYETARJA e Parlamentit të Pakistanit, Fahmida Mirza, gjatë vizitës së parë historike në Shqipëri, ka folur edhe për mundësinë e njohjes së Kosovës nga ky shtet.**

**Kryetarja e Kuvendit, Jozefina Topalli fillimisht tha se i vlerëson qëndrimet pozitive të Pakistanit ndaj Kosovës, si gjatë luftës ashtu edhe pas shpalljes së pavarësisë.**

**“Do të vlerësojmë shumë që Pakistani të çonte më tej këto qëndrime duke njohur pavarësinë e Kosovës, në shërbim të paqes dhe stabilitetit”, ka thënë Topalli.**

**Ndërkaq, Mirza, nga ana e saj, theksoi se “Pakistani e ka seriozisht në konsideratë çështjen e Kosovës dhe se çdo vendim do të merret në përputhje me parimet dhe ligjet ndërkombëtare”. Ajo tha se së shpejti edhe Kryeministri i Pakistanit do të vizitojë Shqipërinë, vizitë që ishte e parashikuar, por u shty për shkak të përmbytjeve në Pakistan.**



Nexhat Daci



Blerim Shala



## Dënohet ish-luftëtari i UÇK-së

SALI REXHEPI është shpallur fajtor me 5 vjet burg nga një trup gjykues i përbërë nga një gjykatës kosovar dhe dy të EULEX-it. Rexhepi, siç njofton EULEX, më 13 tetor u dënua, pasi u shpall fajtor bashkë me të tjerët për torturimin e një personi civil, shqiptar i Kosovës, i mbajtur në qendrën e paraburgimit të UÇK-së në Cahan të Shqipërisë, më ose rreth datës 3 maj 1999. Sali Rexhepi është dënuar vetëm për këtë pikë, ndërsa është liruar nga dy pika të tjera të aktakuzës, që kishin të bënin me krime lufte kundër popullatës civile.

## Plagoset Zvonko Veselinoviq!

BURIME vendore e ndërkombëtare, të portalit LajmeShqip.com, nga veriu i Kosovës kanë bërë të ditur në mbrëmje, në orët e vona, në Mitrovicë, është plagosur kriminel i njohur dhe kapo-banda i veriut të Kosovës, Zvonko Veselinoviq. Bëhet e ditur se ai është plagosur në gju, gjatë një përleshjeje për qërim hesapesh midis grupeve kriminale serbe. Burimi i portalit ka konfirmuar se Veselinoviq është dërguar me urgjencë në spitalin në veri të Mitrovicës, ndërkohë që plagosjen e tij e përgënjeshtroahm mediat serbe në Serbi, por edhe zëdhënësi i Policisë së Kosovës Besim Hoti..





**BESASECURITY**  
KOMPANIA E SIGURIMIT / SECURITY COMPANY

- SIGURIMI FIZIK I OBJEKTEVE TË NDRYSHME
- SIGURIMI I OBJEKTEVE TË NDRYSHME PËRMES SISTEMIT TË ALARMIMIT
- SIGURIMI I OBJEKTEVE TË NDRYSHME PËRMES SISTEMIT TË VIDEO VËZHGIMIT (CCTV)
- SIGURIMI NË VEND I PARAVE DHE SENDEVE ME VLERË SI DHE TRANSPORTIMI I TYRE
- SIGURIMI I HYRJE-DALJEVE NË OBJEKT (ACCESS CONTROL)
- SIGURIMI DHE LOKALIZIMI I OBJEKTEVE DINAMIKE ME GPS/GPRS

038  
044  
049 **54 55 54**

[info@besasecurity.com](mailto:info@besasecurity.com)  
[www.besasecurity.com](http://www.besasecurity.com)



## Durrës, aksident rrugor, shuhet një familje

NJË familje e tërë është aksidentuar për vdekje gjatë natës së premtë në një fshat të Durrësit. Policia bën të ditur se ngjarja ka ndodhur në fshatin Gjopalaj gjatë mesnatës ndërsa shkak i aksidentit mund të ketë qënë furtuna. Pasagjere në automjet ishin Baki Keçi 43-vec e Mimoza Keçi 39- vjec si dhe femijet, Arber Keçi 14 vjec e Renato Keçi 10 vjec, banorë të fshatit Gjopalaj. Sot paradite u gjeten të vdekur 3 prej familjareve ndërsa trupi i një prej fëmijëve që ndodhej në automjet rezultoi i zhdukur në ujrat e kanalit. Policia rreth orës 11:00 gjeti trupin e Renatos 10 vjeçar në ujërat e përroit, pranë Shijakut. Dyshohet se automjeti ka dalë nga rruga dhe ka rënë në një kanal të madh.

## Igumenicë, shkatërrohet një grup trafikantësh i lëndëve narkotike

POLICIA greke e Igumenicës tha se ka shkatërruar një grup trafikantësh të lëndëve narkotike që kishin ngritur rrjetin e tyre në Evropën Perëndimore. Policia tha se hashashi me prejardhje nga Shqipëria transportohej drejt Suedisë me makina tregtare që eksportonin djathin grek. Policia e Igumenicës tha se ka bllokuar gjatë këtij viti në brezin kufitar me Shqipërinë mbi 4 tonë hashash. Departamenti i Narkotikëve në Igumenicë, qytetin fqinj me Sarandën, ka deklaruar se ka goditur një grup të strukturuar që kryente veprime kriminale të vazhdueshme në trafikun e lëndëve narkotike me prejardhje nga Shqipëria drejt Evropës Veriore. Policia greke tha se ka arrestuar tre persona duke sekuestruar mbi 200 kilogramë hashash dhe një arsenal armësh. Operacioni ,sipas policisë greke, është kryer në zonën e Sulit në Greqinë Veriore, zonë që ishte kthyer në bazë të trafikantëve.(VOA)



## Një shqiptare lidhet nga hajnat gjatë plaçkitjes

BBC lajmëron se si mbrëmë një shqiptare, Pranvera Cufaj, ishte lidhur dhe kërcënuar kur plaçkitësit hynë në shtëpinë e saj në Newtownabbey, Irlandë Veriore, Një bandë e meshkujve të maskuar hynë në shtëpinë e saj mbrëmë rreth orës 20.30 dhe vodhën para dhe gjëra personale. Pranvera Cufaj, e cila është me prejardhje nga Shqipëria, tregoi se si plaçkitësit i kishin thënë se familja e saj do të sulmohej nëse ajo nuk do të bënte atë çka

- ata kërkonin. Ajo, burri i saj Fatosi dhe të katër fëmijët ka ca vite që jetojnë në Irlandën Veriore. Pranvera ishte vetë në shtëpi në kohën kur ndodhi plaçkitja.
- "Unë kisha telefonin afër meje dhe tentova të thërras burrin tim." tha ajo.
- "Ata kuptuan se e kisha telefonin dhe e morën atë nga unë. "Tentova të lëviz drejt dritarës që të bërtas për ndihmë, por njëri nga ata më tha se nëse lëvizësh do të vritesh. "Ai tha se e di se ku i ke fëmijët dhe burrin. "Unë isha shumë e frikësuar, unë jam shumë e frikësuar të rri këtu."



## Konflikt për pronat në Gjykatë, vritet 1, plagosen 4 vetë

NJË sherr mes dy familjeve për pronat ka degraduar deri në vrasjen e një personi dhe plagosjen e 4 personave në Lezhë, mes tyre dhe një kalimtar i rastësishëm në vendgjarje. Ngjarja e rëndë ka ndodhur para godinës së Gjykatës së Lezhës ku familjet kishin shkuar për të zgjidhur çështjen e pronave, por që ka përfunduar deri në përdorimin e armëve. Konflikti nisi brenda sallës së gjyqit pa nisur mire gjyqi, ku anëtarët janë kacafytur me njëri-tjetrin dhe janë përleshur edhe fizikisht. Më pas sapo kanë shkelur jashtë godinës së gjykatës, pranë dyerve të gjykatës janë dëgjuar

- të shtëna armësh, ku si pasojë ka mbetur i vrarë në vend, Endri Pepaj, ndërsa janë plagosur 4 persona, 3 prej tyre tepër rëndë për jetën. Të plagosurit Sokol Sejdiu, Arben Marku, Alban Deda janë derguar me plage të rënda në spitalin e Lezhës nga ku mësohet se është e pamundur lëvizja e tyre drejt Tiranës për shkak gjendjes së rëndë. Mësohet se viktimat dhe të plagosurit janë anëtarë të një familjeje. Mes të plagosurve është dhe kalimtari Mark Ndreca që mori plagë teksa ishte duke kaluar pranë Gjykatës.



## Pesë vjet burg për krime lufte

MISIONI i Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë njofton se më 13 tetor, trupi gjyqësor i përbërë nga një gjykatës kosovar dhe dy të EULEX-it e ka shpallur Sali Rexhepin fajtor për një rënie pikë, ndërsa e ka liruar nga dy pikat tjera të aktakuzës

- për krime lufte kundër popullatës civile. "Rexhepi u shpall fajtor bashkë me të tjerët për torturimin e një personi civil, shqiptar i Kosovës, i mbajtur në qendrën e paraburgimit të UÇK-së në Cahan në Shqipëri më ose rreth datës 3 maj 1999", thuhet në njoftimin e EULEX-it. Mësohet se Rexhepi u dënua me pesë vite burgim, ndërsa thuhet se prokurori dhe avokati mbrojtës kanë paralajmëruar ankesë ndaj aktgjyqimit.

# metro life

arts & Entertainment



## SHBA-ja në kundërvitje

QË sot e tutje nuk duhet të merrni asnjë kokërr vitamine, sepse ju bëjnë keq. Deri në ç'pikë? Sa t'ju shkaktojnë vdekjen. E thënë kështu, duket si një kundërrivolucion që rrezikon të përmbysë zakonet e gjysmës së botës. Shteti i parë më i rrezikuar në botë është Amerika, ku vitaminat konsumohen më shumë se një në dy persona. Por realiteti është më i ndërlikuar.

Gjithçka ka lindur nga disa studime që e kanë vënë me kokëposhtë komunitetin shkencor, edhe pse nuk bëhet fjalë për një "shëtitje" rutinë në një laborator. Çdo eksperiment i kryer është fokusuar te jetët e 35 mijë pacientëve. Madje më shumë. Një studim ka lidhje me femrat, ndërsa tjetri me meshkujt. Por për të dyja studimet, përfundimi është i njëjtë. Studimi i parë, i publikuar në "Archives of Medicine", ka ndjekur mjekimet e mijëra femrave nga viti 1986 në 2004-n, dhe ka zbuluar se kush merr vitamina, veçanërisht vitaminën B6 dhe hekurin ka një normë të vdekshmërisë më të lartë se mesatarja. Zbulimi i dytë, i denoncuar nga "Journal of the American Medical Association", vendos në listën e zezë vitaminën E, që çuditërisht deri më sot hidheshin hipoteza se bën mirë, në fakt rrit 17 për qind rrezikun e kancerit në prostatë të meshkujt. Studimet nuk shpjegojnë arsyen përse marrja e tepërt e vitaminave shkakton vdekjen, por vetëm janë mjaftuar me dhënie të statistikave rreth fenomenit. E keqja është se në lojë janë jetët e miliona personave. Është një treg prej 3 miliardë e gjysmë dollarësh. Por kujt duhet t'i besojmë?

"E vërteta është se këto studime nënvijëzuan atë që dinim", thotë doktoresha Diane McCallister, më pas shton: "Vitaminat shtesë duhen konsideruar si ilaçe që kanë efekte". Nga e gjithë kjo duhet të mësojmë që gjithçka të merret me masë. Këtë gjë e mendonin dhe grekët e vjetër: jo më kot përdornin "farmakon" për të treguar ilaçet dhe gjarpurin. Por mesa duket çelësi i vërtetë duket se është një fjalë tjetër: "shtesë". Për çfarë? "Këto studime thonë krejt të kundërtën nga të tjerët: në të vërtetë vitaminat ulin dhe nuk grenë shkallën e vdekshmërisë. Madje unë vetë e rekomandoj përdorimin e tyre, sidomos për të arritur dozën e përditshme të kalciumit, kaliumit, vitaminave D dhe E".

Duke qëndruar sërish në gazetën "Usa Today", një dietologe nga Universiteti i Nju Jorkut, protagoniste e betejave të paharrueshme kundër "fast food"-eve ka thënë: "Ajo që ka më shumë rëndësi është ushqimi. Produktet e duhura. Nëse doni të kujdeseni për veten, atëherë mbani dietë të shën-





# grihet taminave...

detshme: shtesat duhet të përdoren vetëm në ato raste ku diagnostikohet një mungesë e theksuar". Gjithmonë problemi mbetet abuzimi. Kjo gjë vërehet edhe te përdorimi i tepërt i shtesave të hekurit. "Në studim theksohet se vdekshmëria mund të rritet për 80-vjeçarët. Por cila është arsyeja që gratë në atë moshë duhet të marrin vitamina shtesë? Tashmë e kanë kaluar edhe periudhën e menopauzës dhe nuk kanë nevojë të zëvendësojnë dozat e hekurit të humbur gjatë menstruacioneve". Vendimi? "Pjesa më e madhe e njerëzve merr energji mjaftueshëm nga ushqimi dhe vitaminat shtesë duhen marrë vetëm pasi të jeni konsultuar me mjekun", shpjegon doktoresha McCallister.

## Studimi

Në fakt, duke pirë rregullisht çdo ditë vitaminën E, rritet 17% rreziku për të zhvilluar kancerin në prostatë. Të dhënat tregojnë se në 2008-n, shtatë vjet pas nisjes së studimit, çdo 1000 burra 76 prej tyre, pasi kishin marrë çdo ditë vitaminën E në trupin e tyre ishte zhvilluar tumor, kundrejt 65 të tjerëve që kishin marrë thjesht një qetësues të padëmshëm. Në studim u përfshinë 35,33 burra nga shtete të ndryshme të Amerikës, Kanadasë dhe Porto Rikos. Studimi nisi në gusht të vitit 2001. Pacientët u ndanë në katër grupe me 8000 persona: të parit iu dha selen dhe vitamina E, të dytë selen dhe një qetësues të padëmshëm, të tretit vitaminë E dhe një qetësues dhe të fundit vetëm qetësues. Studiuesit zbuluan se meshkujt e grupit të parë dhe të dytë kishin përqindje të zhvillimit të kancerit më të lartë se sa ata që kishin marrë thjesht një qetësues.

"Pas gjithë kësaj është vërtetuar se vitamina E dhe seleni nuk e luftojnë kancerin në prostatë, madje mund të jenë të rrezikshëm", ka thënë Lori Minasian, drejtoreshë e "Division of Cancer Prevention del National Cancer Institute" dhe koordinatore e studimit. "Pavarësisht kësaj, mund të themi se ky lloj studimi është i rëndësishëm për të kuptuar rreziqet e vërteta ose avantazhet e marrjes së vitaminave shtesë". Tani për shkak të rezultateve të publikuara, shkencëtarët po u kërkojnë të gjithë pjesëmarrësve të marrin sërish pjesë në një studim tjetër të gjatë (vazhdimi i të parit), në mënyrë që studiuesit të vazhdojnë të ndjekin rezultatet. Sipas tyre fakti që rreziku është shfaqur vetëm pas një periudhe të gjatë, tregon se efektet anësore të vitaminave mbi shëndetin mund të vazhdojnë edhe pas ndërprerjes së tyre.

## Çokolata e madhe për ditëlindjen e 100-të

ME rastin e 100 vjtorit, kompania Thorntons e ka bërë në Britaninë e madhe çokolatën më të madhe në botë, që peshon gjashtë tonelata. Gjatë proshimit të saj në oborrin e fabrikës Thorntons në Somercotes kanë ndihmuar më shumë s 50 njerëz. Çokolata peshon 583 kilogramë, kurse e mëparshnja e ndërmarrjes Eorl'd's Finest Chocolate peshonte 553 kg. Drejtuesit e fabrikës më të madhe të çokolatave që është themeluar në



vitin 1911 në Sheffield, theksuan se ajo do të ndahet pjesë pjesë dhe do të shitet nëpër dyqane kurse parat e mbledhura do të përdoren për çështje humanitare.

Me më shumë vitamin  
C



## I RI , Andol<sup>®</sup>C më efikas!

## Andol<sup>®</sup>C

Veprim i shpejtë në simptomat e para të ftohjes dhe gripit.  
Veprim i dyfishtë antiinflamator!

*Së bashku drejt shëndetit*

PLIVA

Para përdorimit lexoni me kujdes fletëudhëzimin për barin.  
Pyetni mjekun tuaj për indikacionet, përkujdesjet dhe efektet anësore.

# Adriana Lima pozon për të brendshmet e Victoria's Secret

TË VESHËSH këto të brendshme nuk të ndihmon aspak për t'u ngrohur, por të shohësh Adrianën të veshur me të, e kupton se sa këndshëm ngrihet temperatura!

Modelja braziliane dukej mahnitëse dhe mjaft seksi në këtë koleksion të mrekullueshëm të ri të Victoria's Secret.

Një koleksion që do t'i bëj femrat t'i blejnë veshjet intime menjëherë, teksa shohin meshkujt e tyre tua gllabërojnë revistën nga duart.

30 vjeçarja e veshur me bikini dantelle të zeza dhe rozë, ka treguar trupin e saj të tonifikuar, duke u shfaqur ndjëlëse përpara kamerës dhe duke i lënë shumë pak vend imagjinatës.



## Zara: Çizme për vjeshtë/dimër 2011/2012



JA SE si e imagjinon dimrin që po vjen Zara popullore. Vetëm për ju kemi zgjedhur tetë modele të çizmeve të femrave nga koleksion të ri vjeshtë-dimër, Zara, një nga firmat më popullore në botë. Vështroni në detaje modelët dhe çmimet në galerinë e fotografive.



## Ben Affleck ientuziazmuar për pasardhësin e ri

LAJMI se fëmija i tij i tretë do të jetë djalë, e ka gëzuar pa masë. Çifti hollivudian Jennifer Garner dhe Ben Affleck presin të bëhen me djalë. Garner 39 vjeçare tashmë është shtatzënë për herë të tretë, duke i bërë vajzat e saj Violet 5 dhe Seraphina 2 me një vëlla. Ben Affleck thuhet se është shumë i gëzuar për pjesëtarin e ri mashkull që do të hyj në familjen e tij. Një mik i tij ka treguar për revistën "Life & Style" se ai mezi pret që të luajë bejsboll dhe keç me djalin e tij. Ndërsa Garner duket se është pak e stresuar nga kjo hyrje e re gjinore, pasi i duket sikur nuk do të dijë si të silltet me një djalë, duke qenë se deri tani me vajzat e saj çdo gjë ka qenë instiktive.

## Van Damme i dehur përfundon në hendek

YLLI i Holivudit Jean-Claude Vandamme me veturën e tij ra në hendek pas një dalje të furishme dhe konsumimit të një sasive të madhe të alkoolit. Aktori i famshëm i Holivudit dhe kampion në kik-boks Jean - Claude Vandamme, me veturën e tij në natën e së premtes rrëshqiti në hendek



e më pas me fuqinë e tij u mundua që të nxjerr veturën, por nuk ariti. Incidenti ndodhi pas aktori në vend të rikurcit ndërruesine shpejtësisë e vendosi në shpejtësinë e parë. Vetura "fluturoi" dhe përfundoi në hendek.



**ASUS ROG TYTAN CG8565** në dispozicion konfigurimi me procesorin Core i7-2600K, me 16 GB RAM, diskun prej 2-terabajt dhe SSD-në prej 160-gigabajt, si dhe grafikën GTX 590. Çmimi i kompjuterit me këto pajisje kushton 3,200 euro

## Blerësit e parë të iPhone 4S

AUSTRALIANËT dhe japonezët ishin të parët që patën mundësinë të blinin modelin e fundit të iPhone, i nxjerrë në shitje vetëm pak ditë pas vdekjes së themeluesit të Apple, Steve Jobs. Mijëra persona mbajtën radhë para dyqaneve Apple në Sidnei dhe Tokio për të blerë iPhone S4. “Është fantastike”, tha një 15-vjeçar australian që ka ndenjur 3 ditë me radhë para dyqanit. Skena të ngjashme vetëm pak orë më vonë u panë edhe në Tokio. “Nuk kam mbajtur asnjëherë radhë në jetën time për të blerë diçka, por kësaj radhe u ndjeva i detyruar sepse Jobs vdiq dhe iPhone S4 ishte krijimi i tij i fundit”, shprehet një 24-vjeçar, i cili ka qëndruar 3 ditë e 3 net rresht para dyqanit Apple.



### > iPad 3 gati për prodhim?

PËR një kohë të gjatë nuk është folur për iPad 3, tabletin më të ri të Apple, pasi që së fundmi iPhone 4S e ka marrë të gjithë vëmendjen. Mirëpo, tani sërish kanë filluar thashethemet për iPad 3, ndërsa është All Things Digital mediumi i cili ka disa burime të informacionit për tabletin e ri të Apple. Gjithashtu, sipas Susquehanna Financial thuhet se iPad 3 është nisur për prodhim, dhe ky lajm bazohet në rrejetin e fumizimit të Apple-it.

### > SE heq dorë nga telefonat e zakonshëm

DREJTORI i Sony Ericsson Bert Nordberg paralajmëroi fokusimin më të madh të kompanisë në telefonat e mençur qysh nga viti i ardhshëm. Ai tha se, Sony Ericsson nga viti 2012 do të prodhoj kryesisht smartphone dhe do të ndërpres prodhimin e telefonave të zakonshëm (të thjeshtë, jo-smartphone) dhe featurephonëve për segmentin e poshtëm të tregut.

### > Avioni më kursimtar në botë është sloven



AVIONI sloven i quajtur Taururs është fluturakja më kursimater në botë. Këtë vlerësim e ka bërë agjencia amerikane për hulumtimin e hapësirës NASA, njofton portali kroat dnevnik.rh. Kjo mirënjohje prestigjioze iu ka sjellë konstruktoreve të kësaj fluturake shpërblimin prej 1.3 milion dollarëve amerikanë. “Në shkallën e vlerësimit me nota nga 1 deri në 10, kësaj fluturake do t’ia jepja notën 300, tha Robi Reid, kurse pronari i kompanisë slovene Pipistrel, Ivo Boscarol nuk mund të fshihë krenarinë për këtë të arritur. Avioni Taurus me një mbushje mund të fluturojë më shumë se 400 milje (mbi 650 kilometra), kurse kostoja e fluturimit në relacion të tillë është vetëm 5 euro.

### > 16 tetori, Dita e Steve Jobs

GUVERNATORI i Kalifornisë ka zgjedhur një ditë për ta pagëzuar si dita e Steve Jobs: 16 tetori, data e njëjtë që Apple do të mbajë një moment përkujtimin në Universitetin Standford. Në një cicërimë të dërguar tek më shumë se 1 milion përcjellësit e tij në Twitter gjatë mbrëmjes së të premtës, guvernatori Jerry Brown tha: “Kjo diel do të jetë Dita e Steve Jobs në Shtetin e Kalifornisë.” Disa momente përkujtimore gjithashtu janë bërë për ta nderuar njeriun i cili bashkëthemeloi ndërmarrijen Apple me Steve Wozniak. New York Times raportoi gjatë të premtës që 16 tetori do të jetë dita kur Apple mban një ngjarje përkujtimin për Jobs.



### > S’ka më Google.rs

KOHËT të fundit, motori më i madh i kërkimit në botë, Google.com kishte një problem me përdoruesit e saj shqiptarë në Kosovë, pasi që shfaqte një shkurtësi jo fort të dashur për shqiptarët, domenin Google.rs, në vend të atij universal, Google.com. Mirëpo, me sa duket tani gjithçka është rregulluar, pasi që ofruesi kryesor i internetit në Kosovë, kompania IPKO e ka njoftuar Google për problemin me ri-drejtimin e përdoruesve dhe ndërrimin e gjuhës gjatë qasjes në shërbimet e ndryshme të Google. Në përgjigjen të cilën IPKO ka marrë nga giganti amerikan i teknologjisë thuhet se “ri-drejtimi i përdoruesve të IPKO’s më nuk do të ndodhë, dhe të gjithë ata që vizitojnë Google.com do të mbeten në këtë faqe, dhe jo të ri-drejtohen në Google.rs”. Megjithatë, të gjithë përdoruesit kosovarë të internetit, mund ta provojnë qasjen në Google.com



Jean - Claude Trichet, kryetar i Bankës Qendrore Evropiane

## Trichet: Eurozona nuk është në rrezik

KREU i Bankës Qendrore Evropiane, thotë se traktati i Bashkimit Evropian duhet të ndryshohet për të parandaluar një shtet anëtar të destabilizojë pjesën tjetër e bllokut.

Jean - Claude Trichet, duke folur në një radio franceze dhe intervistë televizive, tha se Evropa ka dështuar për të përbal-

luar krizën globale financiare, për shkak se disa prej anëtarëve të saj nuk i kishin respektuar rregullat e traktatit lidhur me mbikëqyrjen dhe qeverisjen brenda zonës euro.

Trichet, i cili do të largohet nga posti i presidentit të BQE-së në fund të këtij muaji, pas një periudhë tetë-vjeçare,

gjithashtu tha se qeveritë evropiane duhet të lëvizin me urgjencë të madhe për të përballuar krizën që ka goditur eurozonën dhe për të trajtuar situatën e keqe të ekonomisë greke. Ai shtoi se, megjithatë beson që euro do të mbetet një valutë “shumë e besueshme”, dhe se eurozona “nuk është e kërcënuar.”



### Itali, 1 milion euro dëme

“DYQANE të shkatërruara, vitrina të thyera, turistë që janë bllokuar në hotelet e tyre dhe vandalët që vërdallisen nëpër rrugë. Vlera e dëmeve të shkaktuar nga përleshjet e së shtunës shkon në 1 milion euro”. Kështu është shprehur presidenti i Dhomës së Biznesit të Romës, Giuseppe Roscioli, një ditë pas manifestimit të dhunshëm të zhvilluar në kryeqytetin italian nga “Të Indinjuarit”.



Auto shkolla  
**DORA**

044 334 -044  
049

## Izraeli fal 477 palestinezë

IZRAELI publikoi emrat e 477 të burgosurve palestinezë të cilët u lanë të lirë në këmbim të ushtarit të mbajtur peng, Gilad Shalit.

Zyra e Presidentit izraelit, Shimon Peres njoftoi se ai ka nisur nënshkrimin e faljeve individuale. Lista e 450 të

burgosurve meshkuj dhe 27 femrave, të përfshirë në pjesën e parë të marrëveshjes, u bë publike të djelën në mëngjes.

Sic raporton BBC, ata pritet të lihen të lirë të marten si pjesë e marrëveshjes së parë.



## Shtëpia e Bardhë mohon lajmin e agjencisë AP-së

ADMINISTRATA presidenciale e Shteteve të Bashkuara ka mohuar lajmin e agjencisë Associated Press, sipas të cilit trupat amerikane nuk do të qëndrojnë në Irak, pas afatit të përcaktuar në dhjetor.

Zëdhënsi i Shtëpisë së Bardhë, Tomi Vietor, ka thënë se nuk është marrë ende ndonjë vendim definitiv dhe se diskutimet me Irakun "po vazhdojnë." Më shumë se 4,400 antarë të ushtrisë amerikane janë vrarë që kur Shtetet e Bashkuara kanë hyrë në Irak në vitin 2003.



## Ministrat arabë diskutojnë për Sirinë

MINISTRAT e jashtëm arab, u takuan dje në Kairo, për të diskutuar trazirat politike në Siri. Shtetet arabe kishin bërë thirrje më parë për një takim të menjëhershëm të Ligës Arabe për të diskutuar situatën humanitare në Siri, dhe për të

gjetur mënyra të ndalimit të gjakderdhjes, ku sipas OKB-së 3.000 civilë kanë vdekur deri tash në Siri. Raportet thonë se forcat e sigurisë kanë vrarë tre protestues dje dhe kanë lënduar 20 të tjerë, kur kanë hapur zjarr në turmën e njerëzve, në një marsh proteste në kryeqytetin Damaskus. Në lëvizjen e tij të fundit për ta qetësuar këtë pakënaqësi, presidenti Bashar al-Asad ka formuar një komitet për të punuar një kushtetutë të re brenda katër muajve.



**TË paktën 800 milionë njerëz ballafaqohen me uri ose mungesë të ushqimit, paralajmëroi dje Presidenti i Parlamentit Evropian Jerzhi Buzek me rastin e Ditës Botërore të Ushqimit. Organizata FAO bëri të ditur se aktualisht në botë jeton numri më i madh i të uriturve që nga viti 1970, ndërsa një rol të rëndësishëm në rritjen e numrit të të kequshqyerve ka rendimentet e dobëta të shqimit, kushtet e shpeshta ekstreme të motit dhe rritja vjetore e numrit të njerëzve në rreth 80 milionë.**

## Vërshime në Bangkok

PUNON-JËSIT e sektorit të ndihmës për emergjenca, po mundohen të forcojnë barrierat si ndihmë për ta shpëtuar kryeqytetin e Tajlandës, Bangkokun, nga vërshimet më të këqia të këtij vendi në gjysmë shekulli. Përmbytja ka shkatërruar një të tretën e vendit, duke vrarë të paktën 297 njerëz dhe duke shkaktuar rreth 3 miliardë dollarë dëme. Veriu, verilindja dhe qendra e Tajlandës janë goditur më së shumti.



## Vulf, shpreh mbështetje për Afganistanin

PRESIDENTI i Gjermanisë, ka thënë dje se vendi i tij do të vazhdojë të mbështesë Afganistanin, edhe pas tërheqjes së trupave gjermane në vitin 2014. Kristian Vulf, i cili po vizion Kabulin për bisedime me presidentin Hamid Karzai, ka thënë se Gjermania do të mbetet "mike e besueshme dhe e qëndrueshme" e Afganistanit. Gjermania ka rreth 5,000 trupa tani për tani në Afganistan, një vendosje që është thellësisht e papëlqyeshme në mesin e publikut gjerman.

## Lajmi i fundit

PRESIDENTI Barak Obama nderoi dje ikonën e të drejtave civile Martin Luther King duke deklaruar se Amerika duhet të ndjekë shembullin e Dr. Kingut duke vazhduar përpjekjet për një vend më të mirë.

botashkurt



## Sarkozi porositi kafetë, ikën pa paguar

NJË përpjekje e presidentit francez Nikola Sarkozy që të duket si njeri pranë qytetarëve të thjeshtë, duke blerë pije për miqtë e tij në një bar të një fshati francez ka përfunduar "tmerrësisht" keq, kur ai iku pa paguar porosinë, njoftojnë mediat e huaja. Sipas "Mail online", e gjithë skena turpërore ka ndodhur gjatë një vizite që Sarkozy i bëri para disa ditëve Villetelle, një fshat i vogël në



pjesën qendrore të rajonit Creuse, gjatë fushatës për rizgjedhje në postin e presidentit. Duke qëndruar pranë banakut të barit, Sarkozy i ka thënë pronarit të lokalit se "Tash është radha ime", duke porositur gjashtë kafe që kushtonin gjithsej 6 euro e 60 centë, por të cilat nuk i ka paguar, pasi ndërkohë është larguar nga lokali.

# Biznes dhe Financa

biznesdhefinanca@metro-ks.com



Në Paris, po diskutohet kriza evropiane e borxheve Foto: Reuters

## G20 rrit trysninë mbi eurozonën

# Evropianët premtojnë zgjidhjen e krizës

20 EKONOMITË më të mëdha të botës bënë të qartë në Paris se kërkojnë një zgjidhje të shpejtë. Ministri britanik i Financave, George Osborne, e krahasoi situatën madje me një tërmet mbarëbotëror. Kriza e euros është epiqendra e problemeve ekonomike aktuale në botë, tha ai. Evropianët, të cilët duhet të përballojnë rrugën e daljes nga kriza, janë para së gjithash Gjermania dhe Franca. Kjo u bë e qartë vazhdimisht gjatë samitit në Paris. “Kur them ne, atëherë e kam fjalën para së gjithash për ministrin gjerman të Financave Wolfgang Schäuble”, tha më pas edhe mikpritësi, ministri francez i Financave, François Baroin, gjatë konferencës përmblylëse për shtyp. Wolfgang Schäuble nga ana tjetër beson se e ka bindur botën për angazhimin e evropianëve. “Besoj se jemi në rrugë të mbarë. Ua kemi shpjeguar në hollësi këtë kolegëve tanë, por është e rëndësishme, që kjo përgjegjësi të pranohet hapur edhe në kuadër të G20-ës”. Ministri Schäuble la të kuptohej në Paris edhe se kapitalizimi i detyrueshëm është i mundur, në rast se bankat nuk e arrijnë dot financimin me forcat e tyre. Kjo i solli atij kritikë të madhe prej sektorit bankar gjerman. Pika e dytë: Çfarë roli luan fondi i shpëtimit i euros? “Përveç rikapitalizimit të bankave ne do të merremi vesh edhe për masat e nevojshme për një shfrytëzim efektiv të instrumenteve të lehtësimeve të finan-

cimit, kështu që rrezikun e ngjitjes do ta luftojmë në mënyrë parandaluese”, ka thënë Schäuble. Një zgjerim të forcës goditëse financiare për ombrellën e shpëtimit të euros EFSF me ndihmën e një efekti levë nëpërmjet Bankës Qendrore Evropiane (ECB) Schäuble e përjashtoi. Sipas tij ky propozim nuk ka qenë në tryezë. Në rrafsh ndërkombëtar vendet në industrializim e sipër ofruan rritjen e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) për të ndihmuar Evropën. Mirëpo fuqitë ekonomike kryesore nuk u morën dot vesh për këtë. Vendet në industrializim e sipër si Brazili, ose India, me para shtesë duan të shmangin përfshirjen e ekonomive të tyre prej krizës, sepse sikur tregjet të investojnë në mënyrë të shtuar në vendet e tyre, kjo mbiçmon monedhat e tyre dhe i bën eksportet më të vështira. Veç kësaj me mjetet e tyre ato do të kishin më shumë ndikim në FMN. Prandaj ministri amerikan i Financave, Timothy Geithner, e prapësoi këtë propozim në Paris. Këtu ai pajtohet me kolegun e vet gjerman. Edhe vlera e shkurtimit të huave të Greqisë do të vazhdojë të diskutohet në ditët, që vijnë. Në fund të javës së ardhshme shefat e qeverive të BE-së do të paraqesin pastaj propozime për zgjidhje. Në diskutim është edhe ndryshimi i marrëveshjeve të BE-së, për t'i forcuar strukturat në drejtim të një bashkimi stabiliteti. (DV)

## Veprimet e Kinës dëmtojnë ekonomitë në mbarë botën

**PEKINI po sinjalizon se nuk do të epet ndaj presioni të Shteteve të Bashkuara për të lejuar rritjen e vlerës së monedhës kineze.**



**Media kineze citoi kryeministrin Wen Jiabao të ketë thënë se Pekini favorizon një normë këmbimi të qëndrueshme në mënyrë që të mbrojë eksportuesit kinezë.** Udhëheqësi kinez morri pjesë në një panair të eksport-imperteve të organizuar në qytetin e Guangzhou. Media kineze tha se ai bëri thirrje për shtimin e përpjekjeve për të luftuar protektionizmin që po dëmton tregëtinë globale. Shtetet e Bashkuara kanë kohë që e akuzojnë Kinën se manipulon monedhën e saj në mënyrë që eksportet kineze të jenë më të lira krahasuar me mallra të ngjashme të prodhuara në Shtetet e Bashkuara. Gjatë një fjalimi në Nju Jork, sekretarja amerikane e Shtetit Hillary Clinton kritikoi Kinën për atë që e cilësojë si përpjekje për të vënë në lojë sistemin e tregtisë globale. Ajo tha se veprimet e Kinës po dëmtojnë jo vetëm Shtetet e Bashkuara, por ekonomitë në mbarë botën.

## Bie import-eksporti nga Greqia

MARRËDHËNIET ekonomike të Shqipërisë me Greqinë janë në dobësim që prej vitit 2009, ndërsa volumi tregëtar është në rënie të vazhdueshme përsa i përket imperteve dhe eksporteve, raporto mbingjesin e sotëm e përditshmja “Shqip”. Ndërkohë, transporti dhe shërbimi doganor në Greqi do të paralizohen përsëri për 48 orë nga një grevë e përgjithshme në datën 19 tetor, ndërsa një tjetër grevë e shumë sindikatave është në vazhdim, raporto i përditshmja “Shqip” në numrin e saj të djeshëm. Pas marrjes së lajmit për shkurtime të mëtejshme të buxhetit dhe kursimeve me 5 miliardë euro deri në 2015-n, punëtorët grekë, të udhëhequr nga dy sindikatat kryesore, kanë përshkallëzuar protestat.

★★★★★  
HOTEL  
**PRINCI I ARBËRIT**  
*Dhoma duke filluar nga 29.00 euro*

BOWLING FITNESS HALL  
SAUNA  
SALLË KONFERECASH  
SALLË DASMASH DERI 600 ULËSE

Tel: 038/ 244 244  
Mob: 044/ 244 244  
info@hotel-princi-arbrit.com  
www.hotel-princi-arbrit.com

Bujar Gashi  
Hotel Manager

# Biznes dhe Financa

biznesdhefinanca@metro-ks.com



Pamje nga protesta në Nju Jork

## ➤ Mijëra persona në Times Square të Nju-Jorkut

**TË** paktën 45 persona u arrestuan aty dhe 24 të tjerë pranë parkut "Uashington Skuer" po në Nju Jork. Kjo vjen një ditë pas protestave botërore kundër masave për shpëtimin e ekonomisë dhe atë që pjesëmarrësit e cilësojnë babëzi të korporatave.

Por jo vetëm në Nju Jork, protesta u zhvilluan edhe në qytete të tjerë të Shteteve të Bashkuara. Të paktën 5000 persona që u mblodhën në Los Anxheles dhe 2000 të tjerë marshuan në Pitsburg. Në Romë, të paktën 70 persona u plagosën pas një marshimi paqësor, i cili u shndërrua në një betejë të vërtetë.

Persona të veshur me të zeza nisën t'i vënë flakën makinave, sulmuan bankat dhe dyqanet. Kryeministri italian, Silvio Berlusconi, e cilësoi

dhunën një shenjë shqetësuese dhe tha se autorët duhet të kapen dhe të dënohen. Kryebashkiaku i Romës, Xhani Alemano, akuzoi për dhunën disa banda, të mbledhur nga e gjithë Italia e ndoshta nga Europa, të cilët u infiltruan në protestë.

Në Madrid, protesta pati një atmosferë më festive. Dhjetëra mijëra njerëz, të të gjithë moshave, mbushën sheshin Puerta Del Sol të shtunën.

Në Portugali, 20 mijë marshuan në Lisbonë dhe po kaq në Oporto.

Në Greqi, rreth 2000 u mblodhën jashtë parlamentit të Athinës dhe pothuaj kaq në Selanik.

Në Londër u mblodhën rreth 1000 protestues, por u ndaluan nga policia. Protesta të ngjashme u zhvilluan dhe në qytete të ndryshme të Azisë.

■ **KANË** filluar të mbjellat vjeshtore, sipas zyrtarëve të Ministrisë së Bujqësisë deri më tani janë mbjellur 30 për qind e sipërfaqeve të planifikuara për tu mbjellë me grurë. Kjo ministri edhe sivjet do t'i subvencionojnë fermerët për mbjelljet vjeshtore. Masa subvencionuese edhe këtë vit pritet të jetë mbi tre milionë euro, aq sa ishte edhe vitin e kaluar.

## SHBA, falimenton qyteti Harrisburg



NË Shtetet e Bashkuara të Amerikës kriza ekonomike globale është bërë shkak i falimentimit të qytetit Harrisburg, i shtetit të Pensilvanisë si pasojë e një borxhi prej 300 milionë dollarësh. Në Harrisburg, objekti i djegies së mbeturinave i zhvilluar me anë të marrjes së kredisë është bërë shkak i falimentimit.

Kuvendi i qytetit me 50 mijë banorë, duke vënë në veprim një ligj jo tepër të aplikuar më parë, bëri votim dhe me 4 vota pro e 3 vota kundër, mori vendim të shpallë falimentimin.

Kryetarja e Bashkisë së Harrisburgut, Linda Thompson është shprehur se vendimi është i turpshëm dhe ai bie në kundërshtim me ligjin prandaj edhe nuk mund të pranohet. Por administrata e shtetit të Pensilvanisë ka vlerësuar mundësinë e marrjes nën kontroll të qytetit me anë të një plani shpëties.

Në SHBA kjo nuk është hera e parë që një qytet shpall falimentimin.

Që nga viti 1937 e këtej në Amerikë kanë shpallur falimentimin sipas ligjit 629 administrata vendore.

Por falimentimi i qytetit Bridgelport i shtetit Connecticut, në vitin 1991, nuk është pranuar pasi nuk ishte arritur të provohej se borxhet ishin të pa pagueshme.

# Metro marketing

metromarketing@metro-ks.info

**Metro marketing, me dy faqe mundësi për t'u punësuar, për të publikuar njoftimet, shpalljet, shitblerjet.**

**Konkurroni në konkurset e shpallura. Mundësia është kjo: Plotësoni formularin dhe së bashku me CV-në e dërgoni në adresën:**

**info@metro-ks.com.**

**Për ata që dëshirojnë të publikojnë shpalljet, pagesën duhet ta bëjnë në xhironlogarinë e gazetës METRO: 1501060001013579 Raiffeisen Bank.**



044-049/ 510 - 100



Autoshkolla "DORA", shpall

## KONKURS

Për shoferë instruktorë.

Kushtet:

- Kandidatët duhet të kenë patent shoferin e instruktorit të kategorisë B;
- Të jenë të licencuar nga ministria përkatëse;
- Të kenë automjetin e atestuar për ushtrimin e kandidatëve.

Pagesa, sipas marrëveshjes.

Të interesuarit mund të paraqiten për konkurrim në celularin 044/049 334 044.

Metro  
Klasfikimi

METRO  
049  
128  
542

Reklamo këtu

Gazeta METRO - KS shpall

## KONKURS

Për pranimin një numri të pakufizuar të agjentëve të marketingut.

Kushtet:

Kandidati/ja duhet të ketë përvojë pune në fushën e marketingut dhe si dhe të jetë prezentues/e.

Të ketë shkathtësi për të krijuar raporte të mira ndërnjerëzore dhe në komunikim.

Vetëm personat që konsiderohen që janë në listën e ngushtë do të ftohën në intervistë dhe do të njoftoheni përmes email-it tuaj.

Pagesa bëhet në bazë të realizimit, dhe me një rrogë bazë.

Aplikacionet bashkangjitur me foto dorëzohen përmes postës elektronike në adresën: info@metro-ks.com



### Shes banes

Reklamën tuaj mund ta bëni në këtë e-mail: marketing@metro-ks.com

### Blej banesë

Reklamën tuaj mund ta bëni në këtë e-mail: marketing@metro-ks.com

### Shpallje

Shëroj me barishte natyrore këto sëmundje: hemorroidet (majasëllin) e bredshëm dhe të jashtëm, astmën bronkiale, lukthin, psoriazën, prostatën (urinimin). Halil Kajtazi, **Tel: 038 229 193, 049 526 108, 044 181 549.** Adresa: Kodra e Diellit, rruga "Ali Kelmendi", nr. 25, Prishtinë.

### Shes shtëpi

Reklamën tuaj mund ta bëni në këtë e-mail: marketing@metro-ks.com

### Blej shtëpi

Reklamën tuaj mund ta bëni në këtë e-mail: marketing@metro-ks.com

### Shes veturë

Shes **Golf 3/1.8 . Benzin-Plin**, ngjyrë e zezë, viti **1992**. Ka regjistrim deri më **17.5.2012**, është në gjendje shumë të mirë. Na kontaktoni në telefonin: **044/ 744-327** dhe **049/ 324-450**.

### Blej veturë

Reklamën tuaj mund ta bëni në këtë e-mail: marketing@metro-ks.com

### Jap me qira

Reklamën tuaj mund ta bëni në këtë e-mail: marketing@metro-ks.com

### Marr me qira

Reklamën tuaj mund ta bëni në këtë e-mail: marketing@metro-ks.com



**AUTO TRANSPORTUES 24h**

**QELI SERVICE**

**TRANSPORTI: KOSOVË, SHQIPËRI, MAQEDONI DHE MALI I ZI**

Rr. Isa Koastrati,  
Prishtinë - Mirditë (Matiqan)

Mob: 044/ 610 155, 418 612  
044/ 129 795, 149 365

**Reklamo këtu**

049  
128  
542

044  
564  
727

**Reklamo këtu**

049  
128  
542

**Reklamo këtu**

044  
564  
727

marketing@metro-ks.com

**"RIO"**  
**Aksion, Aventurë, Komedi**  
**Kohëzgjatja 1 orë 36 min.**

**TEMA:** "Rio" është një film i animuar i metrazhit të gjatë nga autorët e filmave "Ice age". Filmi komedi, me plot aventura, flet për makaun, i cili vjen në Rio de Zha-neiron e bukur. Makau mendon që është i fundit nga raca e tij. Por, kur kupton që ekziston edhe një makau tjetër, femër, ai ikën nga kafazi i tij dhe nis për në Rio. Por, dashuria nuk vjen në shikim të parë. Femra ishte ndryshe. Ajo ishte e rritur ndryshe dhe e pavarur, jo si Makau, që ishte i butë dhe i qetë. Por, duke u shoqëruar së bashku dhe duke jetuar bashkë për një kohë, ata mësojnë për miqësinë, për dashurinë dhe për trimërinë...

**Rolet:** Jesse Eisenberg, Anne Hathaway, George Lopez, Tracy Morgan, Jemaine Clement. **Regjia:** Carlos Saldanha  
Filmi RIO shfaqet te shtunën dhe të dielën në ora 13:00 dhe 15:00

**Zgjidhje komplete për kontabilitetin dhe financat e kompanisë tuaj në një vend.**

Implementim | Konsulentë | Trajnim | Licenca  
Melita&Partners | 038725930 | info@melita-partners.com

**KOZMETIKA**  
**Golden Rose**

Tel: 044 218 903 / 044 206 - 837  
Rruga Magjistrale Prishtinë - Ferizaj  
(afër Hib Petroll - Çagllavicë)  
e-mail: goldenrose=prishtina@hotmail.com

**Kërkoj bashkëbanues**

Reklamën tuaj mund ta bëni në këtë e-mail:  
marketing@metro-ks.com

**Marr lokal me qera**

Reklamën tuaj mund ta bëni në këtë e-mail:  
marketing@metro-ks.com

Lidhja Auto-Moto e Kosovës  
League Auto-Moto of Kosovo

Lidhja Auto-Moto e Kosovës-LAMK e themeluar në dhjetor të vitit 2010 konform ligjit për sigurinë në komunikacionin rrugor vepron në bazë të principit të organizimit të organizatave simotra Europiane siç janë: ADAC, FIA, ITA, etj., si dhe të atyre në shtetet fqinje të cilat janë me mjaft sukses duke vepruar dhe duke kryer shërbime për automobilistët apo pronarët e automjeteve në vendet e tyre. LAMK është përkujdesur që të formojë dhe konsolidojë shërbimin për ndihmë dhe informata në rrugët e Kosovës e më gjerë, duke ofruar shërbimin e ndihmës dhe informatës për të gjithë automobilistët apo pronarët e mjeteve të regjistruara në Kosovë, të cilët janë të anëtarësuar në LAMK dhe të cilët kërkojnë këtë shërbim nga LAMK përmes numrit karakteristik të telefonit.

**Për më shumë:** Adresa: Lagja e Spitalit, Objekti 2, Kompleksi "Luledielli" 10.000 Prishtinë/Kosovë  
Telefoni: + 377 (0) 44/184-400; + 377 (0) 44/145-807  
E-mail: lamk-ks@hotmail.com

**FALJA E GJAKUT**  
**Zhanri: Dramë; Kohëzgjatja: 1 orë 49 min.**

**TEMA:** Niku është një djalë 17-vjeç në vitin e tij të fundit të shkollës së mesme në Shqipërinë Veriore. Ai fillon romancën e tij të parë me një vajzë nga klasa e tij dhe planifikon të hap një internet kafe pas mbarimit të shkollës. Motra e tij, Rudina, një vajzë e zgjuar, 15-vjeçe dëshiron të shkojë në kolegji. Kur një konflikt lokal mbi një copë toke rezulton në akuzimin e babait të tyre Markut për vrasje, familja futet në një armiqësi gjaku vdekjeprurëse. Ligjet e Kanunit, kodit të vjetër ligjor Ballkanik, detyrojnë Nikun, vëllain e tij 7-vjeç dhe anëtarët e tjerë meshkuj të familjës, që të mbyllën në shtëpi pothuajse sikur në arrest shtëpiak...

Në rolet kryesore: Tristan Halilaj, Refet Abazi, Zana Hasaj, Luan Jaha, Çun Lajçi, Veton Osmani, Selman Lokaj, Sindi Lacey, Ilire Vinca Çelaj, etj. **Regjia:** Joshua Marston. **Skenari:** Andamion Murataj.

Filmi shfaqet në ora 18:00, 20:00 dhe 22:00.

Të shtunën më  
15 Tetor 2011

**Teatri kukullave**  
**"DODONA" shfaq**  
**"Pula këllçoçë e Abës loçë"**

Ora: 12:00; Tel: 038 230 623  
E-mail: dodona1986@yahoo.com

**Reklamo këtu**

044 564 727

marketing@metro-ks.com

# SUDOKU

I lehtë

		4	9	2	3			1
				1	8		3	5
7	1				6	9		2
2			6	8		7	1	
6		5				2		8
	7	8		4	2			6
5		1	2				6	7
3	2		8	9				
4			5	6	1	3		

8		7	4					
		5	3			8		2
		2			1			
7				9		1	8	
9	8						7	5
	5	4		3				6
			5			4		
2		8			6	5		
					4	7		8

Mesatar

				6	2	4	5	3
				1	8			
								7
		9	4	8				1
6								9
	5				1	6	2	
3								
				5	6			
5	2	1	3	4				

I ndërlikuar

# HOROSKOPI



**DASHI (21.3-20.4)**

**Puna:** Keni marrë vendim të gabuar.  
**Shëndeti:** Zbokth në kokë.  
**Dashuria:** Jeta sentimentale është dëshpëruese.



**DEMI (21.4-20.5)**

**Puna:** Ju mungon vetëbesimi.  
**Shëndeti:** Mos konsumoni alkool.  
**Dashuria:** Ju tërheq dikush që e njihni.



**BINJAKET (21.5-20.6)**

**Puna:** Shfrytëzoni rastet që ju jepen.  
**Shëndeti:** Duhet të ecni.  
**Dashuria:** Keni lidhje të fshehtë.



**GAFORRJA (21.6-20.7)**

**Puna:** Mendoni për të gjitha.  
**Shëndeti:** Nuk keni arsye të shqetësoheni.  
**Dashuria:** Merrni hapin.



**LUANI (21.7-20.8)**

**Puna:** Nuk keni ambicie.  
**Shëndeti:** Kujdes nga gripi.  
**Dashuria:** Ditë jo e mire për lidhjen tuaj.



**VIRGJERESHA (21.8-20.9)**

**Puna:** Nuk është një ditë e mirë.  
**Shëndeti:** Vizitoni një psikolog.  
**Dashuria:** Po kaloni ditë të mira.



**PESHORJA (21.9-20.10)**

**Puna:** Suksesi varet nga angazhimi.  
**Shëndeti:** Lehtë mund të sëmurëni.  
**Dashuria:** Personi që kërkoni gjendet pranë.



**AKREPI (21.10-20.11)**

**Puna:** Nuk merrni vendime.  
**Shëndeti:** Gjendje e mirë.  
**Dashuria:** Jeni të dashuruar.



**SHIGJETARI (21.11-20.12)**

**Puna:** Nuk keni mbështetjen e kolegëve.  
**Shëndeti:** Dhimbje muskujsh.  
**Dashuria:** Mbani premtimet.



**BRICJAPI (21.12-20.1)**

**Puna:** Keni filluar siç duhet.  
**Shëndeti:** Vizitoni mjekun tuaj.  
**Dashuria:** Meritoni më shumë.



**UJORI (21.1-20.2)**

**Puna:** Shfrytëzoni aftësitë tuaja.  
**Shëndeti:** Rraskapitje.  
**Dashuria:** Keni lidhje të qëndrueshme.



**PESHQIT (21.2-20.3)**

**Puna:** Kërkoni siguri financiare.  
**Shëndeti:** Qarkullim i dobët.  
**Dashuria:** Keni gjetur mënyrën për t'u kënaqur.

SUDOKU është enigmë me numra në tabelën me 9x9 fusha. Kjo tabelë ndahet përsëri në 9 katrorë ku secili ka 3x3 fusha. Në këto fusha shënohen numrat prej 1-9, ku asnjëri numër nuk guzon të përsëritet as horizontalisht as vertikalisht në kolonat e katrorit të madh 9x9 dhe as në fushat e nënkatorëve të vegjël 3x3. Niveli i vështirësisë së kësaj enigme varet ga sasia e numrave të gatshëm (si ndihmesë) të paraqitur nga përpiluesi. Enigma Sudoku e ka origjinën nga Japonia.



# Ferrari 458 Spider edhe në Prishtinë

SUPER makina Ferrari 458 Spider është gati. Marka e famshme ka nxjerr në shitje modelin më të fundit që kushton afërsisht 230 000 euro. Kjo "kokëkuqe" është parë edhe në Prishtinë. Këtë e dëshmon edhe fotografia e gazetës METRO-

KS. Pesha e makinës është 1430 kg dhe më së shumti përbëhet nga alumini. Makina është e gjatë 4.5 metra dhe e gjerë 1.9 metra. Shpejtësia maksimale është 316 km/h. Kjo makinë pritet të bëhet modeli më i shitur i Ferrarit.



## Automobili më i vjetër shitet për 4.62 milionë dollarë

**AUTOMOBIL** i vitit 1884, me 127 vitet e tij ka ndërruar vetëm katër pronarë, ndërsa shtëpia e ankandit RM Aukcions e ka ofruar me çmimin fillestar prej 500 mijë dollarësh.

Që në fillim të ankandit ishte e qartë se bëhet fjalë vërtetë për një model spektakolar çmimi i të cilit qysh në minutën e parë është ngritur në një milion dollarë.

Siç bëjnë të ditur mediet amerikane, publiku çdo ngritje të çmimit e ka përcjellur me ovacione, ndërkohë që shuma përfundimtare prej 4.62 milionë dollarësh u prit me duartokitje të gjata dhe frenetike. Themeluesi dhe drejtori i tashëm i RM Aukcions Rob Myers nuk ka fshehur kënaqësinë për modelin e shitur:

"Më duhet të pranoj se jemi nderuar që ne patëm rastin ta shesim automobilin më të rëndësishëm nga koleksioni i të ndjerit John O'Quinn.

Për rëndësinë e këtij modeli më së shumti flasin emocionet e mëdha dhe ovacionet spektakolare gjatë ngritjes së çmimit, ndërsa shuma përfundimtare flet qartë. Jam shumë i lumtur!", përfundoi Myers.

Sit back, drift along and lose yourself in the moment. Inside this spacious cabin there's satellite navigation and individual climate control keeping you **COOL AND COLLECTED**. Under the hood there's a 270kW turbo engine and a seamless 8-speed gearbox to get you revved up again. Plus six airbags are installed for your peace of mind. As if you weren't relaxed enough already. You'll be taken away by the **NEW FORD G SERIES**.



**PIXMA**  
**iX6550**

## Small size. Powerful results.

The Canon PIXMA iX6550 is an exceptionally compact A3+ printer - but don't be fooled by its size. This stylish business printer delivers outstanding quality photos and documents at up to A3+. The Canon PIXMA iX6550 offers quality and speed with a print resolution of up to 9600dpi and a 10x15cm photolab-quality print in as little as 36 seconds. Individual ink tanks help increase efficiency whilst also reducing costs and with the online Solution Template service you can download business templates directly into Word to easily create professional documents. This powerful printer proves that really good things do come in small packages.



**Canon**

you can

[canon.co.uk/pixma-ix](http://canon.co.uk/pixma-ix)

## Televizioni Kabllor dhe Digjital



E hënë 17 tetor

07:00 PROGRAMI I MENGJESIT  
 09:30 FILM VIZATIMOR: NOD-DYS FAMILY TREE EP  
 09:43 TOP SHOP  
 09:55 BLOK MUZIKOR  
 10:30 PROGRAMI ARSIMOR:ZBULIMET SHKEN-CORE  
 11:00 LAJMET E ORES 11:00  
 11:08 PROGRAM PER FEMIJE:FEMIJET KENDONJNE  
 11:40 VIDEOKLIPE  
 11:46 AS  
 12:35 MAGAZINA NE GJUHEN BOSHNJAKE MOSTOVI  
 13:00 LAJMET E ORES 13:00  
 13:10 MAGAZINA NE GJUHEN BOSHNJAKE MOSTOVI  
 14:00 DOKUMENTAR: JETË HASANI  
 14:31 NEPER KOMUNA  
 15:00 LAJMET E ORES 15:00  
 15:10 TARGET -  
 16:23 MULTIMEDIA  
 16:59 KFOR SHQIP:PROMOTE LMT  
 17:00 LAJMET E ORES 17:00  
 17:16 KFOR SHQIP:PROMOTE LMT  
 17:17 MAGAZINA NE GJUHEN SERBE: NEDELJNI KOLAZ  
 18:03 LAJMET NË GJUHËN TURKE HABER  
 18:20 LAJMET NË GJUHËN BOSHNJAKE  
 18:36 LAJMET NË GJUHËN ROME  
 18:42 LAJMET NE GJUHEN SERBE VESTI  
 18:58 PROGRAM PER FEMIJE-ALFABETI MAGJIK  
 19:30 LAJME 19:30  
 20:05 10 MINUTA  
 20:15 SPORT PLUS  
 20:26 SERIAL VENDOR: KAFENEJA JONE  
 21:00 KUSH DO TE BEHET MILIONER



22:00 SUBVENCION  
 23:00 LAJMET E ORES 23:00  
 23:19 PA SKENAR  
 23:49 VIDEOKLIPE

E hënë 17 tetor

07:00 Flash  
 07:20 Programi i mëngjesit "Për ditë të mbarë"  
 08:00 Flash  
 08:15 Programi i mëngjesit "Për ditë të mbarë"  
 09:00 Flash  
 09:05 Smart shop  
 09:15 Serial – "Favoritja"  
 10:00 Flash  
 10:05 Smart shop  
 10:30 Emission dokumentar  
 11:00 Flash  
 11:05 Emission dokumentar – (vazhdim)  
 11:30 Top Hop Hiti – emission për fëmijë  
 12:00 Flash  
 12:05 Smart shop  
 12:10 2 me 1 – emission i sportit  
 13:00 Flash  
 13:05 2 me 1 – (vazhdim)  
 13:50 Smart shop  
 14:00 Flash  
 14:05 Bon Bon – magazinë televizive / Mysafirë në studio, Kuriozitete nga bota, Reportazhi: "Kështu thonë qytetarët"



15:00 Flash  
 15:10 Bon Bon – (vazhdim)  
 16:00 Flash  
 16:05 Smart shop  
 16:10 Serial – "Favoritja"  
 17:00 21 Drejtperdrejt  
 17:30 Emission dokumentar  
 18:00 VOA  
 18:30 Reklama  
 18:35 Ditari  
 19:05 Sporti  
 19:10 Reklama  
 19:15 Fjalë të urta  
 19:20 Film vizatimor  
 19:30 Edhe unë jam Kosovë Trajtohet gjendja sociale e familjeve kosovare  
 20:00 Flash  
 20:05 Kabare  
 21:55 Reklama  
 22:00 21 Minuta  
 22:35 Sporti  
 22:40 Reklama  
 22:45 Serial-"Favoritja"  
 23:45 Just Kidding

E hënë, 17 tetor

07:00 Programi i mëngjesit  
 09:30 Sistina emision i shëndetësisë Dr. Zharko Hristovski  
 09:52 Film vizatimor: Baskerville  
 11:00 Emissioni: Zona e debatit (R)  
 13:00 Lajmet 13/00  
 13:30 Moti  
 13:35 Serial: Anatomia e Greit (R)  
 14:15 Trip Lista – top lista muzikore (R)  
 15:00 Lajmet Flash  
 15:15 Exclusive (R)  
 16:30 Seriali: Alias, episodi 22



17:30 INFO Magazine – emission informativ  
 18:20 Ora e Pasditës, pjesa 1; Ora e pasditës pjesa 2  
 20:00 Lajmet 20/00  
 20:35 Moti  
 20:45 Zona B  
 21:30 Fringe, episodi 4  
 22:30 Lajmet 22/30  
 23:02 Moti me Nekin  
 23:10 Minuta e fundit, emission sportiv  
 00:00 Seriali: Alias (R)  
 00:45 Zona B R  
 01:20 Info Magazine  
 02:00 Ora e Pasditës R  
 03:15 Lajmet 22/30  
 03:45 Moti  
 04:00 Fringe  
 05:00 Minuta e fundit  
 05:45 Sistina emision i shëndetësisë Dr. Zharko Hristovski  
 06:00 Video gazmore  
 06:30 Kënga magjike.

## Rikthehet "Kafeneja jonë"



SHIKUESIT e Televizionit të Kosovës, sërish do të kenë mundësi të shohin në ekranin e vogël serialin e ri kumoristik "Kafeneja jonë". Pas një pushimi të shkurtër, Orhan Tullum'i, Labinot Koka, Naim Shatci, Saranda, Meli etj. do të rikthehen në skenë, mbase edhe me risi që nuk i kemi hasur në episodet e shkuara...

## Seriali: Alias

EPISODI 22. Sydney Bristow ishte rekrutuar si spiune për të punuar ne skuadren SD-6, të cilën ajo mendoi se ishte një agjenci qeveritare. Megjithatë, kur i fejuari i saj vritet nga agjentët të SD-6, ajo konstaton se ky është një skuadër anti-qeveritare.



## Vdes futbollisti Fisnik Muharremi

FUTBOLLISTI nga Mitrovica, Fisnik Muharremi (26) ka ndërruar jetë të enjtën pas një lufte të gjatë që pati me kancerin në mushkëri. Muharremi ishte



operuar së pari në Prishtinë, e më pas edhe jashtë vendit, ndërsa nishta të shumta ishin organizuar për ta ndihmuar ish-futbollistin e Trepçës 89', por ai nuk arriti të shpëtonte dhe të enjten ndërroi jetë. Fisnik Muharremi, u varros dje me nderime të larta dhe u nderua nga bashkëlojtarët e ish-skuadrës së tij dhe shumë adhurues të sportit mitrovicas e më gjërë.

## Gascoigne zbulon sekretet

**NJË legjendë e futbollit anglez, pranoi se thithte rregullisht kokainë dhe konsumonte deri në nëntë teke uiski, përpara një ndeshjeje. 44-vjeçari pretendon se diçka e tillë e bëntë të kthjellët dhe të fuqishëm në fushë, duke e ndihmuar që të shënonte disa prej golave që e bënë të paharrueshëm për të gjithë tifozët e tij. Në një intervistë befasuese në një televizion britanik, ish-futbollisti i Njukasëll, Tottenham, Everton dhe Lacio, ndër të tjera, foli edhe për anën më të errët të jetës së tij, atëherë kur varësia nga droga e bëri që të ishte aq paranojak, sa që të besonte se mund të vdiste nëse do të pinte ujë.**



## EURO 2012, SHORTI I PLAY-OFF

### Turqia ndeshet më Kroacinë

TURQIA - Kroacia, Estonia-Irlanda, Republika Çeke-Mali i Zi dhe Bosnje Hercegovina-Portugalia janë çiftet e ndeshjeve rikualifikuese për Euro 2012 pas shortit të zhvilluar të enjten në Krakovë të Polonisë. Sipas koeficienteve të UEFA-s, Kroacia,

Portugalia, Republika e Irlandës dhe Republika Çeke ishin koka grupi në short dhe për këtë arsye do të luajnë ndeshjet e para në fushë kundërshtare dhe ndeshjet e kthimit në shtëpi. Ndeshjet e para do të luhen më 11/12 nëntor ndërsa ato të kthimit më 15 nëntor.



BeH - Portugalia  
Turqia - Kroacia  
Estonia - R. e Irlandës  
Republika Çeke - Mali i Zi



# Kombëtarja me apo pa përzgjedhës të huaj?

Nga **Besim KAJTAZI**

TASHMË kanë përfunduar ndeshjet mënjaneuse për Euro 2012, që do të mbahet në Poloni dhe Ukrainë. Përfaqësuesja e Shqipërisë edhe një herë dështoi tërësisht në rrugëtimin e saj për të realizuar ëndrrën e kahmotëshme që quhet kualifikim. Dështimi është i qartë dhe ai duhet t'i shkruhet në rend të parë përzgjedhësit kroat Josip Kuzhe, të cilin e angazhoi dy vjet më parë presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit Armand Duka. Përzgjedhësi kroat nga dhjetë ndeshjet e zhvilluara arriti vetëm dy fitore dhe tri barazime, duke pësuar pesë herë dhe me 9 pikë të tubuara zuri vendin e pestë në Grupin D, ku kualifikimin siguroi Franca, me 21 pikë, përfaqësuese kjo e cila e mposhti Shqipërinë dy herë. Kulmi i dështimit erdhi kur kombëtarja u mposht nga Luksemburgu 2:1 dhe barazimi në shtëpi në ndeshjen e

fundit kundër Rumanisë 1:1. Kombëtarja shqiptare nuk u ripëtëri me gjak të ri siç pati premtuar Kuzhe. Këtë nuk e bënë as tre përzgjedhësit e mëparshëm Otto Bariç dhe Hans Peter Briegel e Ari Han e as para tyre italiانى Dosena... Qe turpi të jetë edhe më i madh, u përkujdes spresidenti Armand Duka, i cili trajnerit dështak Kuzhe i ofroi rinovim të kontratës! Ndërkohë në skenë nisën të lakohen dy emra të mundshëm të trajnerëve shqiptar, të cilët do të mund të drejtonin skuadrën përfaqësuese në periudhën e ardhshme. Janë këta ish-futbollisti i mirënjohur i kombëtares Rudi Vata dhe Besnik Hasi, i cili aktualisht është ndihmëstrajner në skuadrën më të trofeshme të Belgjikës, RSC Anderlecht. Emërimi i

ndonjërit prej këtyre emrave do të ishte i mirëseardhur për kombëtaren shqiptare, ngase askush më shumë se këta të dy Hasi e Vata nuk e njohin mentalitetin e futbollit shqiptar. Është koha e fundit që t'i jepet fund aventurave me trajnerë të huaj, të cilat Shqipërisë tash dhjetë vjet nuk i sollën asnjë dobi. Në hapësirën e futbollit tonë ekzistojnë shumë trajnerë të kualifikuar shqiptarë, të cilët kombëtaren do të drejtonin më me sukses se sa kroati Josip Kuzhe. Përveç Rudi Vatës e Besnik Hasi, aty do të mund të konkurronin pa problem edhe dy trajnerë nga Kosova, Bylbyl Sokoli dhe Afrim Tovërlani e mbase edhe ndonjë tjetër. Drejtuesit e FSHF-së vetëm duhet të lirohen nga sindromi se vetëm trajnerët e huaj mund ta shpëjnë kombëtaren përpara. Përvoja e deritashme e ka vërtetuar të kundërtën...

**SUPERLIGA E KOSOVËS NË FUTBOLL****Drita rrëmben kreun****KF Drita, edhe pas dhjetë xhirove, mbetet e pamposhtur**

DRITA pas humbjes së Prishtinës 1:0 nga Drenica në Skenderaj, me fitore të pastër 2:0 ndaj KEK-ut, rrëmbeu kreun e renditjes në Superligën e Kosovës. Për gjilanasit kanë shënuar Isufi në minutën 24 dhe Osmani në atë 58, dhe tash për tash Drita mbetet e vetmja skuadër që nuk ka asnjë humbje, me 22 pikë të tubuara nga dhjetë takime të zhvilluara. Prishtina dje u mposhtë në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj, nga Drenica 1:0, ndërsa golin e fitores e ka shënuar ish-futbollisti

bardhekaltër, tash dirigjenti i lojës së kuqezinjëve Talu-ant Dajaku.

Në këtë ndeshje u shquan dy mesfushorët vendas Dajaku e Kaçiu.

Prishtina ka luajtur 30 minuta pa kapitenin Azem Ahmeti, pas përjashtimit me karton të kuq, ndërsa gjyqtari Hajriz Hajdari e ka përjashtuar edhe kryetrajnerin e Prishtinës, Ramiz Krasniqi.

Në stadiumin "Riza Lushta" në Mitrovicë, Trepça 89 dhe Liria i ndanë pikët duke luajtur baraz 2:2 dhe është kjo një pikë e

rëndësishme e prizrenasve, pas një varg rezultatesh të dobëta. Në Gjakovë ka mjaftuar një gol i Skerajit për fitoren prej 1:0 të Vëllaznimit në përballje me Gjilanin, gol ky që e mban skuadrën gjakovare në garë për titullin e kampionit. Kampioni në fuqi Hysi edhe këtë të diele dështoi, madje në shtëpi, duke luajtur baraz me Beën 1:1. Fitore të rëndësishme ka shënuar Lepenci në Kaçanik, duke mundur Trepçën e Mitrovicës 2:1. Kjo ndeshje u zhvillua pa praninë e shikuesve...

**Superliga – Java 10**

Trepça '89 - Liria	2:2
Drenica – Prishtina	1:0
Drita- KEK-u	2:0
Vëllaznimi – Gjilani	1:0
Hysi – Besa	1:1
Lepenci – Trepça	2:1

**Renditja**

1. Drita	10	6	4	0	16:5	22
2. Prishtina	10	6	2	2	15:7	20
3. Vëllaznimi	10	5	4	1	11:6	19
4. Trepça '89	10	4	4	2	15:12	16
5. Trepça	10	4	2	4	11:10	14
6. Drenica	10	3	4	3	10:11	13
7. Lepenci	10	3	4	3	7:8	13
8. Hysi	10	3	3	4	12:12	12
9. Besa	10	3	2	5	12:16	11
10. KEK-u	10	3	1	6	11:16	10
11. Gjilani	10	2	1	7	8:15	7
12. Liria	10	2	1	7	6:16	7

**Liga e parë – java 10**

Sharri – Hajvalia	1:1 (u ndërpre 88')
Ulpiana – Vitia	2:1
Feronikeli – Ferizaj	3:0
F.Kosova – R.Sadiku	1:0
Flamurtari – 2 Korriku	0:0
Rahoveci – Deçani	1:3
Ballkani – Kosova	3:0
Llapi – Istogu	sot

**Renditja**

1. Ferronikeli	10	28
2. Ferizaj	10	19
3. Ballkani	10	18
4. Flamurtari	10	17
5. Ulpiana	10	16
6. Hajvalia	9	15
7. Llapi	9	14
8. Fushë Kosova	10	14
9. 2 Korriku	10	13
10. Deçani	10	13
11. Istogu	9	12
12. Kosova	10	11
13. Ramiz Sadiku	10	9
14. Vitia	10	7
15. Sharri	9	5
16. Rahoveci	10	5

**LIGAT EVROPIANE****Premier liga**

Liverpool - Manchester U.	1:1
Manchester C. - Aston Villa	4:1
Norwich - Swansea C.	3:1
Q P R. - Blackburn R.	1:1
Stoke. – Fulham	2:0
Wigan - Bolton W.	1:3
Chelsea – Everton	3:1
W. Bromwich - Wolverham.	2:0
Arsenal – Sunderland	2:1
Newcastle - Tottenham	2:2

**Serie A**

Catania -Inter	2:1
Milan - Palermo	3:0
Napoli - Parma	1:2
Cesena – Fiorentina	0:0
Atalanta – Udinese	0:0
Cagliari – Siena	0:0
Chievo – Juventus	0:0
Genoa – Lecce	0:0
Novara – Bologna	0:2

**Bundesliga 1**

Werder - Borussia D.	0:2
Bayern M. - Hertha	4:0
Mainz - Augsburg	0:1
Monchenglad. – B.Leverkusen	2:2
Stuttgart - Hoffenheim	2:0
Wolfsburg - Nurnberg	2:1
Schalke – Kaiserslautern	1:2
Freiburg - Hamburger	1:2
Cologne – Hannover	2:0

**Primera Division**

Getafe -Villarreal	0:0
Mallorca – Valencia	1:1
Real Madrid - Real Betis	4:1
Barcelona -Santander	3:0
Granada - Atletico M.	0:0
R. Vallecana-Espanyol	0:1
Zaragoza- Sociedad	2:0
Levante –Malaga	3:0

**Ligue 1**

Auxerre – Lille	1:3
Brest – Caen	1:1
Evian - Saint-Etienne	1:2
Lyon - Nancy	4:1
Montpellier - Dijon	5:3
Toulouse – Marseille	0:0
Nice - Bordeaux	3:0
Ajaccio - Paris S.G.	1:3
Valenciennes - Sochaux	3:0

## Formula 1: Çmimi i madh i Japonisë

## Kampioni sërish i pari

TITULLI i dytë kampion nuk ia ka ulur aspak ritmin Sebastian Vetelit, i cili në garën e Koresë sërish ka arritur të fitojë duke çuar në dhjetë numrin e sukseseve sezonale.

Gjermani ka marrë vendin e parë që në fillimin e garës duke lënë pas ngasësin britanik Luis Hamilton dhe e mbajti atë deri në fund pa e diskutuar në asnjë moment. Në të njëjtën mënyrë edhe britaniku, i skuadrës McLaren ka arritur ta kalojë i dyti vijën e finishit pas një dueli të ashpër me pilotin tjetër të skuadrës Red Bull, Mark Veber i cili pavarësisht tentativave në disa raste nuk mundi të marrë vendin e dytë, duke mbyllur gjithçka në Kore me vendin e tretë. Pas tyre një garë larg protagonistëve kanë zhvilluar piloti tjetër i McLaren-it Xhenson Baton dhe spanjulli i Ferrarit, Fernando Alonso i cili e kaloi finishin në vendin e pestë pa patur mundësinë për të bërë më mirë.



Sebastian Vettel

Në këtë mënyrë është mbyllur edhe gara e 16-të e këtij sezoni, ku skuadra Red Bull falë fitores së Sebastian Vetelit dhe vendit të tretë të Mark Veber arriti të shpallet edhe kampione për konstruktorë, duke i mbyllur objektivat 3 gara përpara fundit të sezonit. Gara e radhës do të jetë Çmimi i Madh i Indisë më 30 tetor.

Shtatzënë, përfundon  
maratonën dhe shkon  
në lindje

AMERIKANIA Amber Miller (27 vjeçare) nga Chicago arriti ta përfundojë vrapimin në maratonë, e më pas lindi fëmijën. Amber vendosi të vrapojë në maratonë edhe pse ishte në javën e 38-të të shtatzanisë, shkruan gazeta prestigjioze Daily Telegraph. Pasi vrapoi maratonën, shkoi drejtë e në spital dhe lindi. Ajo lindi vajzë të cilën e pagëzoi June. Nëna krenare e përfundoi maratonën për 6 orë e 25 minuta. Foshnja e saj peshon 3.45 kilogramë. Amber e kaloi gjysmën e maratonës duke vrapuar, ndërsa gjysmën tjetër duke ecur.



Lindja Hospital offers:

- \* Gynecology
- \* Urology
- \* Pediatrics
- \* X-Ray
- \* Biochemistry (Lab)
- \* In Vitro Fertilization (IVF)



INFO recepcioni: 038 602 -100, 044 586 - 736  
INFO In Vitro Fertilization (IVF): 045 283 - 465